



SOCIETE GENERALE GROUP

BANKA POPULLORE SH.A.

**Pasqyrat Financiare Individuale
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2009
(dhe raporti i auditorit të pavarur)**



Raporti i auditorit të pavarur

Aksionerëve të Banka Popullore sh.a.:

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të veçanta të Banka Popullore sh.a ("Banka"), bashkangjitur, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2009, pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave, pasqyrën e ndryshimit të kapitalit, pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje e parimeve bazë kontabël dhe shënimeve të tjera shpeguese. Pasqyrat financiare të Bankës për vitin e mbyllur në 31 Dhjetor 2008 ishin audituar nga një auditor tjetër i cili në raportin e tij datë 17 Prill 2009 shprehu një opinion të pa kaulifikuar mbi këto pasqyra.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare pa pasaktësi materiale, si pasojë e mashtrimeve apo e pasaktësive; përzgjedhjen dhe zbatimin e politikave kontabël të përshtatshme për rrethanat.

Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është që bazuar në auditimin tonë, të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare. Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarte, kërkojnë që ne të përmbushim kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditim, me qëllim që të përfitojmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk kanë pasaktësi materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për sigurimin e të dhënave të auditimit, për vlerat dhe deklaratimet në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshi këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të ekzistencës së gabimeve në pasqyrat financiare, qofshin këto si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve. Gjatë vlerësimit të rreziqeve, auditori merr në konsideratë merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin për përshtatshmërinë e parimeve kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kryesore të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se të dhënat e auditimit që kemi marrë ofrojnë baza të mjaftueshme dhe të përshtatshme për dhënien e opinionit të auditimit.

Opinion

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare të veçanta paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Bankës më 31 Dhjetor 2009, si dhe rezultatin e operacioneve të saj dhe rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur më këtë datë, në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Deloitte Albania shpk

25 mars, 2010

Deloitte Albania sh.p.k

Pasqyra e pozicionit financiar

	Shënime	31 dhjetor 2009	31 dhjetor 2008
Aktivët			
Paraja dhe ekuivalentët e saj	5	1,792,012	2,790,660
Shuma të kushtëzuara me Bankën Qëndrore	6	2,975,644	2,876,617
Hua dhe parapagime ndaj institucioneve financiare	7	240,474	286,345
Investime të vlefshme për shitje	8	14,832,681	16,712,884
Hua dhe paradhënie për klientët, neto	9	16,005,294	12,917,019
Hua dhënë Qeverisë Shqiptare	10	1,454,864	-
Aktive të trupëzuara, neto	11	1,044,082	997,063
Aktive të patrupëzuara, neto	12	255,717	4,863
Parapagim tatim fitimi		-	14,113
Aktive fikse të mbajtura për shitje	13	78,742	2,800
Aktive të tjera	14	116,024	98,279
Investimi në filial	15	100,000	-
Totali i aktiveve		38,895,534	36,700,643
Detyrimet			
Detyrime ndaj bankave e institucioneve financiare	16	2,520,248	2,988,868
Detyrime ndaj klientëve	17	31,754,275	29,896,283
Tatimi i shtyrë	18	32,263	49,718
Detyrime të tjera	19	248,434	384,672
Totali i detyrimeve		34,555,220	33,319,541

(Të gjitha shifrat janë shprehur në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

Kapitali				
Kapitali aksioner	20	4,449,450		2,933,000
Primi i aksioneve		1,750		1,750
Rezerva ligjore		4,618		31,184
Rezerva për ndryshimet në vlerën e drejtë		(14,079)		43,282
(Humbje e akumuluar) / Fitim i pashpërndarë		(101,425)		371,886
		4,340,314		3,381,102
Totali detyrimeve dhe kapitalit aksioner		38,895,534		36,700,643

Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare nga faqja 7 deri në faqen 53, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra përmbledhëse e të ardhurave

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2009	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2008
Të ardhura nga interesat	21	2,897,658	2,823,454
Shpenzime për interesat	22	(1,656,558)	(1,520,537)
Të ardhura neto nga interesat		1,241,100	1,302,917
Të ardhura nga komisionet		76,467	68,834
Shpenzime për komisionet		(26,773)	(16,475)
Të ardhura neto nga komisionet		49,694	52,359
Fitimi nga kurset e këmbimit		199,698	52,489
Humbja nga shitja e aktiveve të trupëzuara		(17,064)	(5,163)
Humbje nga zhvlerësimi	9	(465,260)	(109,143)
Zhvlerësimi i aktiveve të trupëzuara		(159,396)	(124,371)
Amortizimi i aktiveve të patrupëzuara	12	(4,103)	(3,443)
Shpenzime personeli		(589,243)	(461,534)
Shpenzime të përgjithshme administrative		(772,755)	(650,596)
		(1,990,757)	(1,349,087)
(Humbja) / Fitimi para tatimit		(517,329)	53,515

(Të gjitha shifrat janë shprehur në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

Tatim mbi fitimin	25	17,455	(14,242)
(Humbja) / Fitimi neto i periudhës		(499,874)	39,273
Të ardhura të tjera			
Rezerva për ndryshimet në vlerën e drejtë			
Ndryshimi neto në vlerën e drejtë të letrave me vlerë të vlefshme për shitje		(57,361)	43,282
Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin		(557,235)	82,555

Pasqyra përmbledhëse e të ardhurave duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare nga faqja 7 deri në faqen 53, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e ndryshimit të kapitalit

	Kapitali aksioner	Primi i aksioneve	Rezerva ligjore	Rezerva për ndryshimet në vlerën e drejtë	(Humbja e akumuluar)/ Fitimi i pashpërndarë	Totali
Gjendja më 1 janar 2008	2,933,000	1,750	30,204	(22,440)	333,593	3,276,107
Transferim në rezervën ligjore	-	-	980	-	(980)	-
Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin						
Fitimi neto i periudhës	-	-	-	-	39,273	39,273
Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve të tjera për vitin						

Ndryshimi neto në vlerën e drejtë të letrave me vlerë të vlefshme për shitje	-	-	-	65,722	-	65,722
Gjendja më 31 dhjetor 2008	2,933,000	1,750	31,184	43,282	371,886	3,381,102
Kapitali i nënshkruar	1,732,900	-	-	-	-	1,732,900
Kapitali i nënshkruar por i papaguar	(216,450)	-	-	-	-	(216,450)
Korrigjimi i rezervës ligjore	-	-	(26,566)	-	26,566	-
Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin						
Humbja për vitin	-	-	-	-	(499,874)	(499,874)
Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve të tjera për vitin						
Ndryshimi neto në vlerën e drejtë të letrave me vlerë të vlefshme për shitje	-	-	-	(57,361)	-	(57,361)
Gjendja më 31 dhjetor 2009	4,449,450	1,750	4,618	(14,079)	(101,425)	4,340,314

Pasqyra e ndryshimeve të kapitalit duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare nga faqja 7 deri në faqen 53, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

(Të gjitha shifrat janë shprehur në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

Pasqyra e rrjedhës së parasë

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2009	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2008
Rrjedha e parasë nga operacionet:			
(Humbja) / fitimi para tatimit		(517,329)	53,515
<i>Rregullime për të kuadruar rezultatin neto me rrjedhjen neto të aktiveve monetare nga veprimtaritë operative:</i>			
Zhvlerësimi	11	159,396	124,371
Amortizimi	12	4,103	3,443
Humbje neto nga zhvlerësimi i kredive	9	465,260	109,143
Aktivet e trupëzuara të nxjerra jashtë pozicionit financiar		3,786	6,551
Aktivet e patrupëzuara të nxjerra jashtë pozicionit financiar		13,279	-
Të ardhura nga interesi	21	(2,897,658)	(2,823,454)
Shpenzime interesi	22	1,656,557	1,520,537
Rrjedha e parasë nga veprimtaritë operative para ndryshimeve në aktivet dhe detyrimet operative		(1,112,606)	(1,005,894)
Ndryshim në aktivet dhe pasivet operative:			
(Rritja)/pakësimi në shuma të kushtëzuara me Bankën Qëndrore		(99,513)	234,409
Pakësimi në huatë dhënë bankave		46,674	790,874
Rritje në hua dhe paradhënie për klientët		(4,919,210)	(2,872,899)
(Rritje)/pakësim në aktive të tjera		(79,575)	364,988
(Pakësim)/rritje në detyrimet ndaj institucioneve financiare		(480,228)	2,371,141
Rritje/(pakësim) në detyrimet ndaj klientëve		1,855,212	(3,060,008)

(Pakësim)/rritje në detyrime të tjera		(136,240)	183,161
Interesi i arkëtuar		2,808,152	2,821,795
Interesi i paguar		(1,642,171)	(1,481,373)
Tatim fitim i paguar		-	(14,113)
Paraja neto e përdorur për aktivitetin operativ		(3,759,505)	(1,667,919)
Rrjedha e parasë nga veprimtaritë investuese:			
Investimi në filial		(100,000)	-
Blerje e letrave me vlerë		1,822,843	(99,706)
Blerje e aktiveve të patrupëzuara		(268,236)	(3,842)
Blerje e aktiveve të trupëzuara		(210,200)	(492,112)
Rrjedha neto e parasë e gjeneruar/(përdorur) në veprimtaritë investuese		1,244,407	(595,660)
Para të gjeneruara nga veprimtaritë financuese:			
Të hyra nga emetimi i aksioneve		1,516,450	-
Dividendi i paguar		-	-
Rrjedha neto e parasë e gjeneruar nga veprimtaritë financuese		1,516,450	
Pakësimi neto në para dhe ekuivalentët e saj		(998,648)	(2,263,579)
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit	5	2,790,660	5,054,239
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit	5	1,792,012	2,790,660

Pasqyra e rrjedhës së parasë duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare nga faqja 7 deri në faqen 54, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare u miratuan nga Drejtimi i Bankës më 23 mars 2010 dhe janë firmosur nga:



Hubert De Saint Jean
Drejtore i Përgjithshëm



Albana Hallvaxhiu
Zv Drejtore e Financës

Shënime për pasqyrat financiare

1. Të përgjithshme

- Banka Popullore Sh.a (“Banka”) është një institucion financiar i themeluar më që Banka mori duke filluar nga data 12 dhjetor 2003 sipas ligjit mbi shoqëritë tregtare dhe u liçencua nga Banka e Shqipërisë më 16 shkurt 2004 (vendimi nr.17) që të operojë si bankë në të gjitha fushat e aktivitetit bankar në Shqipëri në përputhje me ligjin Nr.8365 “Mbi sistemin bankar në Shqipëri”, i muajit korrik 1998. Banka është gjithashtu subjekt i ligjit Nr.8269, i dhjetorit 1997, “ Mbi Bankën e Shqipërisë”. Banka ka filluar aktivitetin më 1 mars 2004. Bazuar në marrëveshjen e blerjes së aksioneve që daton më 18 prill 2007, Societe Generale bleu 75.01% të aksioneve të Bankës.
- Më 21 gusht 2009 Banka ka krijuar filialin e saj “Sogelease Albania sh.a” të cilin e zotëron plotësisht. Banka ka publikuar pasqyrat financiare të konsoliduara më 15 prill 2010.
- Më 31 dhjetor 2009, Banka ka operuar përmes zyrave qendrore që ndodhen në Tiranë dhe 41 degëve të saj (2008: 41 degë). Banka ushtron aktivitetin vetëm brenda territorit gjeografik të Shqipërisë. Më 31 dhjetor 2009 Banka kishte 379 punonjës (31 dhjetor 2008: 460 punonjës).

2. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të reja dhe të rishikuara

2.1 Standarde dhe Interpretime në fuqi në periudhën raportuese

Ndryshimet e mëposhtme të standardeve ekzistuese të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe interpretimet e publikuara nga Komiteti i Interpretimeve të Raportimeve Financiare Ndërkombëtare janë në fuqi për periudhën raportuese:

- SNRF 8 “*Segmentet Operative*” (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 datës janar 2009), të publikuara nga BSNK më datë 30 nëntor 2006. Ky Standard zëvendëson SNK 14 “Raportimi për Segmentet” dhe ndërmjet të tjerave kërkon që segmentet operative të përcaktohen në përputhje me raportet e brëndshme mbi përbërësit e një entiteti të aktivitetit subjekt i rishikimeve periodike nga një anëtar i drejtimit përgjegjës për vendime operative me qëllim caktimin e burimeve dhe vlerësimin e performancës. Ky standard nuk ka efekt në raportimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të Bankës ose në kapitalin e saj.
- Ndryshimet e SNRF 4 “*Kontratat e sigurimeve*” dhe SNRF 7 “*Instrumentat Financiare: Paraqitja*.” përmirësojnë raportimet mbi instrumentat financiarë (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2009), të publikuara nga BSNK më 5 mars 2009. Ndryshimet e SNRF 7 parashtrajnë një hierarki me tre nivele për matjen e vlerës së drejtë i kërkon entiteteve të prezantojnë paraqitje shtesë mbi besueshmërinë relative të matjes së vlerës së drejtë. Gjithashtu, ndryshimet qartësojnë dhe zgjerojnë kërkesat ekzistuese

për paraqitjen e rrezikut të likuiditetit.

- Ndryshimet e SNRF 1 *“Adoptimi për herë të parë i SNRF”* dhe SNK 27 *“Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe Individuale”*. Kosto e investimit në një filial ose shoqëri të kontrolluar bashkërisht ose nga një sipermarrje (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2009), të publikuara nga BSNK më datë 22 maj 2008. SNRF 1 e rishikuar lejon njohjen e investimeve në filiale, shoqëri të kontrolluara bashkërisht dhe të matura në kosto, sipas metodës së “kostos së konsideruar”. Adoptuesit për herë të parë të SNRF mund të zgjedhin metodën e matjes për çdo investim në mënyrë që disa të maten në përputhje me parimet e përgjithshme të SNK 27, ndërsa disa të tjera me koston e konsideruar. Kosto e konsideruar mund të matet me vlerën e drejtë, në përputhje me SNK 39, ose me vlerën kontabël e cila rezulton nga metodat kontabël të aplikuara më parë. Për investimet e matura me koston e konsideruar, zgjedhja ndërmjet vlerës së drejtë dhe vlerës së mbartur të llogaritur në përputhje me metodat e mëparshme kontabël bëhet në mënyrë individuale për çdo investim.

2. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të reja dhe të rishikuara

2.1. Standarde dhe Interpretime në fuqi për periudhën raportuese (vazhdim)

Bordi hoqi kërkesën për njohje më vete të dividendit para blerjes dhe dividendit pas blerjes nga përkufizimi i matjes me koston e konsideruar të përfshirë në SNK 27. Ky standard tani aplikon kërkesat e përgjithshme të SNK 18 “Të Ardhurat” dhe kërkon që dividendët e marra nga filialet, shoqëritë e kontrolluara bashkërisht ose me sipërmarrje të njihen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave kur e drejta e shoqërisë për të marrë dividendë është e përcaktuar. Ndryshimet e mësipërme nuk kanë të bëjnë me operacionet e Bankës.

- Përmirësimet e SNRF-ve, “Ndryshimet mbi Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar 2009” të publikuara nga BSNK më datë 16 prill 2009. Ndryshimet e standardeve e interpretimeve të ndryshme që rezultojnë nga Projekti i Përmirësimit Vjetor të Cilësisë së SNRF (SNRF 2, SNRF 5, SNRF 8, SNK 1, SNK 7, SNK 17, SNK 18, SNK 36, SNK 38, SNK 39, KIRFN 9, KIRFN 16) me synim parësor heqjen e mospërputhjeve e qartësimin e të shprehurit. Rishikimet qartësojnë njohjen e kërkuar kontabël në rastet ku interpretimi i lirë lejohej. Ndryshimet më të rëndësishme përfshijnë kërkesa të reja ose të rishikuara më lidhje me: (i) qëllimi i SNRF 2 dhe SNRF 3 i rishikuar, (ii) publikimet e aktiveve fikse (ose grupet për nxjerrje) të klasifikuara si të mbajtura për shitje apo operacionet e ndërprera, (iii) publikimi i informacionit mbi aktivet e segmenteve, (iv) klasifikimi afat-shkurtër/jo afat-shkurtër i instrumentave të konvertueshëm, (v) klasifikimi si shpenzim për aktivet e panjohura, (vi) klasifikimi i qerave të tokës dhe ndërtesave, (vii) përcaktimi nëse një entitet vepron si kryesor apo si agjent në programet e besnikërisë së klientëve, (viii) njësia kontabël për testin e zhvlerësimit të emrit të mirë, (ix) ndryshime shtesë që lindin si pasojë e rishikimit të SNRF 3; dhe që masin vlerën e drejtë të aktiveve të pa trupëzuar të blera në një kombinim biznesi, (x) trajtimi i gjobave të parapagimit të huasë si derivativë pjesë përbërëse dhe të lidhur ngushtësisht me to; përjashtimi nga qëllimi për kontratat e kombinimeve të biznesit; kontabiliteti i mbrojtjes së rrjedhës së parasë, (xi) qëllimi i KIRFN 9 dhe të SNRF 3 të rishikuar, (xii) ndryshimet e kufizimit mbi një shoqëri që mund të mbajë instrumenta mbrojtëse. Ndryshimet mësipër nuk kanë sjellë një ndikim të konsiderueshëm në pasqyrat financiare individuale të Bankës.
- Ndryshimet e SNK 32 dhe SNK 1 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare – Instrumentat Financiarë me të Drejtë Shitjeje dhe Detyrimet që Rrjedhin nga Likuidimi (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2009), të publikuara nga BSNK më datë 14 shkurt 2008. Rishikimet kanë të bëjnë me emetuesit e instrumentave financiare: (1) me opsionin për të shitur ose (2) instrumentat ose përbërësit e tyre, të cilat e detyrojnë shoqërinë të transferojë pjesë proporcionale të aktiveve neto të shoqërisë një pale tjetër vetëm në rastet e likuidimit të tij. Sipas SNK 32 të rishikuar, me kusht që plotësohen kritere specifike, këto instrumenta klasifikohen si kapital. Para rishikimit, ato klasifikoheshin si detyrime financiare. Sipas SNK 32 të rishikuar, disa instrumenta financiare me opsion shitjeje dhe ato të cilat e detyrojnë emetuesin t’i transferojë mbajtësit pjesë proporcionale në aktivet neto të shoqërisë me likuidimin e saj klasifikohen si kapital. Rishikimet i referohen çdo lloj instrumenti më vete dhe përcaktojnë kritere të detajuara për t’u plotësuar në mënyrë që të mundësojnë paraqitjen e një instrumenti si kapital.
- SNK 1 i rishikuar “Paraqitja e Pasqyrave Financiare një paraqitje e rishikuar” (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2009), publikuar nga BSNK më 6 shtator 2007. Standardi i rishikuar ndalon paraqitjen e zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve (d.m.th ndryshimet në kapital që nuk i përkasin pronarit) në pasqyrën e ndryshimeve të kapitalit, të cilat kërkojnë që ndryshimet në kapital që nuk i përkasin pronarit të paraqiten më vete prej ndryshimeve në kapital që i përkasin pronarit. Të gjitha ndryshimet në kapital që nuk i përkasin pronarit kërkohej të paraqiten në një pasqyrë performance, por shoqëritë mund të zgjedhin të paraqesin një pasqyrë performance (pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse totale) ose dy pasqyra (pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe pasqyra përmbledhëse e të ardhurave).

2. Aplikimi Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të reja dhe të rishikuara (vazhdim)

2.1 Standarde dhe Interpretime në fuqi për periudhën raportuese (vazhdim)

Atëherë kur shoqëritë rivlerësojnë ose riklasifikojnë informacion krahasues atyre u kërkohet të paraqesin një pasqyrë të pozicionit financiar të rivlerësuar nga fillimi i periudhës krahasuese përveç kërkesës aktuale për të paraqitur pasqyrën e pozicionit financiar në fund të periudhës raportuese dhe periudhës krahasuese;

- SNK 23 i rishikuar *“Kostot e Huamarrjes”* (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë nga 1 data janar 2009) të publikuara nga BSNK më datë 10 janar 2008. SNK 23 i rishikuar kërkon kapitalizimin e kostove të huamarrjes që lidhen me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e një aktivi të kualifikuar (që kërkon një kohë të gjatë për të qenë gati për qëllim përdorimi ose shitje) si pjesë e kostos së atij aktivi. Opsioni i futjes menjëherë në shpenzime i këtyre kostove të huave është hequr. SNK 23 i rishikuar nuk është i aplikueshëm për operacionet e Bankës sepse ajo nuk ka ndonjë aktiv të kualifikuar për të cilin kostot e huasë të kapitalizohen.
- Ndryshimi i SNKR 2 *“Pagesa të Bazuara në Aksione – “Kushtet e të Drejtave dhe Anullime”* (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas data 1 janar 2009), (publikuar nga BSNK më datë 17 janar 2008). Ky ndryshim kufizon kushtet e të drejtave me kushtet e shërbimit dhe kushtet e performancës. Karakteristika të tjera të pagesave të bazuara në aksione nuk janë kushte të drejtash. Ndryshimet e SNKR 2 nuk lidhen me operacionet e Bankës pasi Banka nuk ka ndonjë plan kompensimi të bazuar në aksione.
- Ndryshime të KIRFN 9 *“Rivlerësimi i Derivatëve të Përfshirë”* dhe SNK 39 *“Instrumentat Financiarë: Njohja dhe Matja – Derivatët e Përfshirë”* (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 30 qershor 2009), (publikuar nga BSNK më datë 12 mars 2009) që qartëson se riklasifikimi i një aktivi financiar jashtë kategorisë “me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes” të gjithë derivativët e përfshirë duhet të vlerësohen dhe nëse është e nevojshme të llogariten në mënyrë individuale në pasqyra financiare individuale.
- KIRFN 13 *“Programet e Besnikërisë së Klientëve”* (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 korrik 2008). Interpretimi adreson kontabilitetin e njësive ekonomike që i dhurojnë pikë krediti klientëve të tyre. Një njësi ekonomike do t'i kontabilizojë pikët e kreditit si një komponent i identifikueshëm më vete i transaksionit të shitjes në bazë të të cilit ato janë dhuruar (‘shitja fillestare’). Vlera e drejtë e konsideratës së marrë ose të arkëtueshme në lidhje me shitjen fillestare do të alokohet ndërmjet pikëve të kreditit dhe komponentëve të tjerë të shitjes. KIRFN 13 nuk ka çuar në ndryshime në politikat kontabël të Bankës pasi ai nuk ka të bëjë me operacionet e Bankës.
- KIRFN 15 *“Marrëveshjet për Ndërtimin e Pasurive të Patundshme”* (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2009), publikuar nga BSNK më datë 3 korrik 2008. KIRFN 15 trajton dy çështje (të lidhura): përcakton nëse një kontratë ndërtimi është subjekt i SNK 11 “Kontratave të Ndërtimit” ose SNK 18 “Të Ardhurat” dhe kur të ardhurat nga ndërtimi i pasurive të patundshme duhet të njihen si të ardhura. Interpretimi ofron udhëzues shtesë mbi dallimin midis ‘kontratave të ndërtimit’ (që lidhen me qëllimin e SNK 11) dhe marrëveshjeve të tjera për ndërtimin e pasurive të patundshme (që lidhen me qëllimin e SNK 18). Marrëveshjet që përfshijnë ndërtimin e pasurive të patundshme duhet të ekzaminohen me kujdes për të përcaktuar nëse ato duhet të kontabilizohen në përputhje me SNK 11 ose SNK 18. Njësitë ekonomike më të ndikuara ka të ngjarë të jenë ato që ndërmarrin ndërtimin e zhvillimeve me shumë njësi.

2. Aplikimi i Standardeve Ndërkobëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të reja dhe të rishikuara (vazhdim)

2.1 Standarde dhe Interpretime në fuqi për periudhën raportuese (vazhdim)

Për marrëveshjet që lidhen me qëllimin e SNK 18 dhe që përfshijnë furnizimin me mallra, interpretimi ka prezantuar një koncept të ri, që kriteret e njohjes së të ardhurave mund të plotësohen në mënyrë të vazhdueshme si ndërtime në proces sipas SNK 18.

Në këto rrethana, të ardhurat njihen duke ju referuar fazës së përfundimit të ndërtimit duke përdorur metodën e përçindjes së kompletimit. KIRFN15 nuk lidhet me operacionet e Bankës pasi Banka nuk ofron shërbime të ndërtimit të pasurive të patundshme ose zhvillim të pasurive të patundshme për shitje.

2.2. Standarde dhe interpretime në publikim akoma të pa adoptuara

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare individuale, standardet, rishikimet dhe interpretimet e mëposhtme ishin në publikim por akoma jo në fuqi:

- SNRF 9 “*Instrumentat Financiarë*” (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013), publikuar nga BSNK më datë 12 nëntor 2009. Standardi përdor një përçasje të vetme për të përcaktuar nëse një aktiv financiar është matur me koston e amortizuar apo me vlerën e drejtë duke zëvendësuar shumë rregulla në SNK 39. Përçasja në të cilën SNRF 9 bazohet mbi faktin se si një njësi ekonomike manaxhon instrumentat e saj financiarë (modeli i saj i biznesit) dhe karakteristikat e rrjedhjeve kontraktuale të parasë të aktiveve financiare. Ky standard i ri gjithashtu kërkon përdorimin e një metode të vetme zhvlerësimi duke zëvendësuar kështu përdorimin e shumë metodave të zhvlerësimit sipas SNK 39. Banka është momentalisht në procesin e vlerësimit të ndikimit të mundshëm të këtij standardi. Nisur nga natyra e operacioneve të Bankës, ky standard pritet të ketë një ndikim të konsiderueshëm në pasqyrat financiare të Bankës.
- SNRF 3 i Rishikuar *Kombinimet e Biznesit* (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas 1 korrikut 2009), publikuar nga BSNK më 10 janar 2008. SNRF 3 i rishikuar kërkon njohjen e kostove të blerjes në shpenzimet e periudhës. Rishikimet e SNRF 3 dhe ndryshimet përkatëse në SNK 27 e kufizon aplikimin e parimeve kontabël të blerjes vetëm në momentin e kalimit të kontrollit të plotë; për rrjedhojë emri i mirë llogaritet vetëm në atë datë. SNRF 3 zhvendos më shumë fokusin në vlerën e drejtë në datën e blerjes, duke dhënë detaje për njohjen e saj. Ndryshimi në këtë standard lejon matjen e interesave jo të kontrolluara (para ndryshimit të interesave të pakicës në njësinë e blerë me vlerë të drejtë ose në mënyrë proporcionale me aksionet e tij në aktivet neto të identifikueshme të njësisë së blerë. Standardi i rishikuar kërkon matjen e vlerës së lidhur me blerjen me vlerë të drejtë në datën e blerjes. I njëjti parim aplikohet për vlerën e drejtë për çdo konsideratë të mundshme për t’u paguar. SNRF 3 lejon shumë pak rregullime vlerësimit e bëra në momentin e njohjes fillestare të kombinimit dhe vetëm nëse këto rregullime vijnë si rezultat i informacioneve shtesë të marra në lidhje me fakte dhe rrethana ekzistuese në datën e blerjes.

2. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të reja dhe të rishikuara (vazhdim)

2.2. Standarde dhe interpretime në publikim akoma të pa aplikuar

Çdo ndryshim tjetër njihet në fitim/humbje. Standardi përcakton ndikimin e kontabilitetit të blerjes në qoftë se blerësi dhe i bleri ishin palë në një lidhje të mëparshme. SNRF 3 përcakton që një njësi ekonomike duhet të klasifikojë të gjitha termat kontraktuale në datën e blerjes me dy përjashtime: qeratë dhe kontratat e sigurimit.

- Ndryshimet në SNRF 1 *“Aplikimi për herë të parë i SNRF”*- Përjashtimet Shtesë për Aplikuesit për herë të Parë (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2010), publikuar nga BSNK më 23 korrik 2009. Ndryshimet: (1) përjashtojnë njësitë ekonomike të cilat përdorin metodën e kostos së plotë nga aplikimet në retrospektivë të SNRF-ve për aktivet e naftës dhe të gazit, (2) përjashtojnë njësitë ekonomike me kontrata ekzistuese qeraje nga rivlerësimi dhe klasifikimi i këtyre kontratave në përputhje me KIRFN 4 duke përcaktuar nëse një Marrëveshje përmban një Qera kur aplikimi i kërkesave të standardeve kombëtare të kontabilitetit ka prodhuar të njëtin rezultat. Ky ndryshim i SNRF 1 që bëhet i detyrueshëm për pasqyrat financiare të Bankës për vitin 2010 nuk ka të bëjë me operacionet e Bankës.
- Ndryshimi në SNRF 1 *“Adoptimi për herë të parë i SNRF”*- Përjashtimi i Kufizuar nga Publikimet Krahasuese të SNRF 7 për adoptuesit për herë të parë (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas 1 korrikut 2010), publikuar nga BSNK më datë 28 janar 2010. Ky ndryshim i lehtëson adoptuesit për herë të parë të SNRF nga paraqitja e publikimeve shtesë të prezantuara në mars 2009 për Përmirësimin e Publikimeve rreth Instrumentave Financiarë (Ndryshimet në SNRF 7). Ndryshimet e SNRF 1 të cilat bëhen të detyrueshme për pasqyrat financiare të Bankës për 2010 nuk kanë të bëjnë me operacionet e Bankës.
- Ndryshimi në SNRF 2 *“Pagesat e Bazuara në Aksione”* Transaksionet e pagesave në grup të bazuara në aksione të cilat ekzekutohen me para në dorë (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datë 1 janar 2010), të publikuara nga BSNK më datë 18 qershor 2009. Ndryshimet qartësojnë: (1) qëllimin e SNRF 2. Një njësi ekonomike që merr mallra ose shërbime të sipas një marrëveshjeje pagese të bazuar në aksione duhet t'i kontabilizojë këto mallra ose shërbime pavarësisht se cila prej njësive të grupit e ekzekuton transaksionin, dhe pavarësisht nëse transaksioni ekzekutohet në aksione apo para në dorë. (2) ndërlidhja e SNRF 2 me standardet e tjera. Bordi qartësoi se në SNRF 2 një 'grup' ka të njëjtin kuptim si në SNK 27 Pasqyrat Financiare të konsoliduara dhe individuale, d.m.th., ai përfshin vetëm një mëmë dhe filialet e saj. Ndryshimet në SNRF 2 gjithashtu përfshijnë udhëzime të cilat më parë përfshiheshin në KIRFN 8 Qëllimi i SNRF 2 dhe KIRFN 11 SNRF 2 – Transaksionet e Grupit dhe të Aksioneve të Thesarit. Si rrjedhim BSNK ka tërhequr KIRFN 8 dhe KIRFN 11. Ndryshimet do të jenë të detyrueshme për pasqyrat financiare të Bankës të vitit 2010 dhe nuk kanë të bëjnë me operacionet e Bankës pasi Banka nuk ka vendosur plane pagese në formë aksionesh për personelin ose drejtorët e saj.
- Ndryshimet në SNK 24 *“Publikimet për Palët e Lidhura”* – Duke thjeshtuar kërkesat për publikim për njësitë ekonomike shtetërore dhe duke qartësuar përkufizimin e një pale të lidhur (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2011), publikuar nga BSNK më datë 4 nëntor 2009. Ndryshimet sigurojnë një përjashtim të pjesshëm për njësitë ekonomike shtetërore. Deri tani nëse një njësi është e kontrolluar apo e influencuar në mënyrë të dukshme nga qeveria i kërkohej të publikonte informacion për të gjitha transaksionet me të gjitha njësitë e kontrolluara ose influencuara dukshëm nga ajo qeveri. Standardi i rishikuar akoma kërkon publikime që janë të rëndësishme për përdoruesit e pasqyrave financiare por eliminon kërkesat për publikim të informacionit që është i kushtueshëm për tu mbledhur dhe s'ka vlerë për përdoruesit. BSNK gjithashtu ka thjeshtuar përkufizimet dhe ka hequr mospërputhjet.

2. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të reja dhe të rishikuara (vazhdim)

2.2. Standarde dhe interpretime në publikim akoma të pa aplikuar

- SNK 24 i rishikuar nuk ka të bëjë me pasqyrat financiare të Bankës pasi Banka nuk është një njësi ekonomike shtetërore dhe përkufizimi i rishikuar i një pale të lidhur nuk pritet të rezultojë në një marrëdhënie të re që kërkon publikim në pasqyrat financiare.

Ndryshimet në SNK 32 “Instrumentat Financiarë: Prezantim” – Kontabiliteti për emetimet e të drejtave (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 shkurt 2010) publikuar nga BSNK më datë 8 tetor 2009. Ndryshimi adreson kontabilitetin për emetimet e të drejtave (të drejtat, opsionet ose garancitë) të cilat denominohen në një monedhë të ndryshme nga monedha funksionale e emetuesit. Më parë, të drejta të tilla kontabilizoheshin si detyrime derivative. Ndryshimi kërkon që këto të drejta emetimi klasifikohen si kapital pavarësisht nga monedha në të cilën denominohet çmimi i ekzekutimit, me kusht që të plotësohen disa kushte të caktuara. Ndryshimet e SNK 32 nuk kanë lidhje me pasqyrat financiare të Bankës pasi Banka në të kaluarën nuk ka emetuar instrumenta tillë .

- Ndryshimet në SNK 39 “Instrumentat Financiarë”: Njohja dhe Matja – Instrumentet mbrojtës (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 korrik 2009), publikuar nga BSNK më datë 31 korrik 2008. Standardi i rishikuar shpjegon dy çështje të kontabilitetit për mbrojtjet: duke identifikuar inflacionin si një rrezik të mbrojtur ose pjesë të tij dhe mbrojtjen me opsione. Ndryshimet bëjnë të qartë se inflacioni mund të mbrohet vetëm në rastet kur ndryshimet e inflacionit janë një pjesë e specifikuar në mënyrë kontraktuale e rrjedhës së parave të një instrumenti financiar të njohur. Ndryshimet gjithashtu qartësojnë që një normë interesi pa rrezik ose referencë, pjesë e vlerës së drejtë të instrumenti financiar me normë fikse normalisht do të jetë i identifikueshëm më vete dhe i matshëm në mënyrë të besueshme dhe, për rrjedhojë, mund të mbrohet. SNK 39 i rishikuar lejon që një njësi ekonomike të caktojë opsione të blera (ose të blera neto) si instrumenta mbrojtës në mbrojtjen e një zëri financiar ose jo financiar. Një njësi ekonomike mund të caktojë një opsion si një mbrojtje ndaj ndryshimeve të flukseve të parasë ose vlerës së drejtë së një zëri të mbrojtur mbi ose nën çmimin e specifikuar ose variabël tjetër (një rrezik i njëanshëm). Ndryshimet do të bëjnë të detyrueshme për pasqyrat financiare të Bankës për vitin 2010 dhe do të kërkojë aplikim në retrospektivë. Banka në këtë moment është në procesin e vlerësimit të efektit potencial të këtij ndryshimi.

- Ndryshimet e standardeve dhe interpretimeve të ndryshme që rezultojnë nga projekti i përmirësimeve vjetore të cilësisë së SNRF publikuar më datë 16 prill 2009 (SNRF 2, SNRF 5, SNRF 8, SNK 1, SNK 7, SNK 17, SNK 18, SNK 36, SNK 38, SNK 39, KIRFN 9, KIRFN 16) në radhë të parë heqjen e mos përputhjeve dhe qartësimin e fjalorit, (ndryshimet më të shumta janë për tu aplikuar për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2010), publikuar nga BSNK më datë 16 prill 2009. Rishikimet qartësojnë njohjen e kërkuar kontabël në rastet ku interpretimi i lirë lejohej. Ndryshimet më të rëndësishme përfshijnë kërkesa të reja ose të

rishikuara më lidhje me: (i) qëllimi i SNRF 2 dhe SNRF 3 i rishikuar, (ii) publikimet e aktiveve fikse (ose grupet për nxjerrje) të klasifikuara si të mbajtura për shitje apo operacionet e ndërprera, (iii) publikimi i informacionit mbi aktivet e segmenteve, (iv) klasifikimi afat-shkurtër/jo afat-shkurtër i instrumentave të konvertueshëm, (v) klasifikimi si shpenzim për aktivet e panjohura, (vi) klasifikimi i qerave të tokës dhe ndërtesave, (vii) përcaktimi nëse një entitet vepron si kryesor apo si agjent në programet e besnikërisë së klientëve, (viii) njësia kontabël për testin e zhvlerësimit të emrit të mirë, (ix) ndryshime shtesë që lindin si pasojë e rishikimit të SNRF 3; dhe që masin vlerën e drejtë të aktiveve të pa trupëzuar të blera në një kombinim biznesi, (x) trajtimi i gjobave të parapagimit të huasë si derivativë pjesë përbërëse dhe të lidhur ngushtësisht me to; përjashtimi nga qëllimi për kontratat e kombinimeve të biznesit; kontabiliteti i mbrojtjes së rrjedhës së parasë,

2. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të reja dhe të rishikuara (vazhdim)

2.2. Standarde dhe interpretime në publikim akoma të pa aplikuar

(xi) qëllimi i KIRFN 9 dhe të SNRF 3 të rishikuar, (xii) ndryshimet e kufizimit mbi një shoqëri që mund të mbajë instrumenta mbrojtëse. Ndryshimet e standardeve dhe interpretimeve të ndryshme të cilat do të bëhen të detyrueshme për pasqyrat financiare të Bankës në vitin 2010 nuk do të kenë një ndikim të konsiderueshëm në pasqyrat financiare të Bankës.

- Ndryshimet e KIRFN 14 “SNK 19 — Limit mbi një Aktiv me përfitim të përcaktuar, kërkesat e Financimit Minimal dhe Ndërlidhja mes tyre” – Parapagimet e një Kërkesë Minimale për Financim (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2011), publikuar nga BSNK më datë 26 nëntor 2009. Pa ndryshimet, në disa rrethana njësitë ekonomike nuk lejohen të njohin si aktiv parapagimet vullnetare për kontribute minimale financimi. Ndryshimet e korrigjojnë këtë problem. Ndryshimet e KIRFN 14 nuk kanë të bëjnë me pasqyrat financiare të bankës pasi Banka nuk ka plane me përfitim të përcaktuar me kërkesa për financim minimal.
- KIRFN 17 “Shpërndarja e Aktiveve Jo Monetare Pronarëve” (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 korrik 2009), publikuar nga BSNK më datë 27 nëntor 2008. Interpretimi ofron udhëzues mbi trajtimin e përshtatshëm kontabël kur një njësi ekonomike i shpërndan aksionerëve të saj aktive të ndryshme nga ato monetaret si dividendë. Konkluzioni më thelbësor i arritur nga KIRFN është që dividendët duhet të maten me vlerën e drejtë të aktiveve të shpërndara dhe çdo diferencë ndërmjet kësaj shume dhe asaj së mëparshme të mbartur kur aktivet janë shpërndarë duhet të njihen si fitim ose humbje kur njësi ekonomike e shlyen dividendin e pagueshëm. Interpretimi nuk aplikohet për aktivet jo monetare nëse shpërndarja nuk rezulton në ndryshim kontrolli. Ndërkohë që interpretimi bëhet i detyrueshëm për pasqyrat financiare individuale të Bankës për vitin 2010 dhe do të aplikohet në të ardhmen, ai nuk do të ketë impakt në pasqyrat individuale për periudhat para datës së adoptimit të interpretimit. Më tej, duke qenë se ai lidhet me dividendët e ardhshëm të cilët do jenë në autoritetin e bordit të drejtorëve ose aksionerëve, nuk është e mundur që efekti i këtij aplikimi të përcaktohet në avancë.
- SNK 27 i ndryshuar “Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe Individuale” (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 korrik 2009), publikuar nga BSNK më datë 10 janar 2008. Në kushte specifike lejohet të aplikohet më parë. Sipas standardit të rishikuar, ndryshimet në interesin e blerësit në filialin e tij që nuk rezultojnë në humbje kontrolli kontabilizohen në kapital si transaksione me pronarët në kapacitetin e tyre si pronarë. Për të tilla transaksione nuk njihet humbje/fitim dhe emri i mirë nuk rimatet. Çdo diferencë ndërmjet ndryshimit të interesave jo të kontrolluara dhe vlerës së drejtë të konsiderimit të paguar ose të marrë njihet direkt në kapital dhe i atribuohet pronarëve të mëmës. Standardi përcakton procedurat kontabël për tu aplikuar nga mëma nëse humbet kontrolli ndaj një filiali. Ndryshimet në SNK 28 dhe SNK 31 zgjerojnë kërkesat në lidhje më kontabilitetin për humbjet e kontrollit. Nëse atëhere një investitor ka humbur ndikim të rëndësishëm në sipërmarrjen e tij njësi ekonomike duhet të ç’rregjistrohet dhe diferenca ndërmjet totalit të rrjedhës monetare hyrëse dhe interesit të ruajtur në vlerën e drejtë dhe vlera e mbartur e investimit në sipërmarrje në datën e humbjes së kontrollit njihet në fitim ose humbje. Një përqasje e ngjashme kërkohet në qoftë se një investitor humbet kontrollin mbi një njësi të kontrolluar bashkërisht. Ndryshimet në SNK 27, të cilat bëhen të detyrueshme për pasqyrat financiare individuale të Bankës të vitit 2010 nuk kanë të bëjnë me operacionet e Bankës.

2. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të reja dhe të rishikuara (vazhdim)

2.2. Standarde dhe interpretime në publikim akoma të pa aplikuar

- KIRFN 18 "*Transferimi i Aktiveve nga Klientët*" publikuar nga BSNK më datë 29 janar 2009. Ky interpretim është i një rëndësie të veçantë për sektorin e shërbimeve publike pasi qartëson kontabilitetin për marrëveshjet kur një njësi ekonomike merr një aktiv të trupëzuar (ose para në dorë për të ndërtuar një zë të tillë) nga një klient dhe ky aktiv nga ana tjetër përdoret për të lidhur një klient në një rrjet ose për të siguruar hyrje në furnizim me mallra ose shërbime. Ndryshimet në KIRFN nuk kanë të bëjnë me pasqyrat financiare të Bankës.
- KIRFN 19 "*Mbyllja e Detyrimeve me Instrumenta Kapitali*" (efektiv për periudhat raportuese që fillojnë më ose pas datës 1 korrik 2010), publikuar nga BSNK në datë 26 nëntor 2009. Interpretimi qartëson kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimeve Financiare (SNRF) kur një njësi ekonomike rinegocion termat e një detyrimi financiar me kreditorët e tij dhe kreditori bie dakort të pranojë aksionet e shoqërisë ose instrumenta të tjera kapitali për të shlyer plotësisht ose pjesërisht detyrimin financiar. Banka nuk emetoi kapital për të mbyllur ndonjë detyrim financiar gjatë periudhës raportuese. Për këtë arsye, ky interpretim nuk do të ketë ndikim mbi shumat krahasuese në pasqyrat financiare individuale të Bankës për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2009. Më tej, duke qene se interpretimi mund të lidhet vetëm me transaksione që do të ndodhin në të ardhmen nuk është e mundur të përcaktohen më parë efektet që do të ketë aplikimi i këtij interpretimi.

Banka ka zgjedhur të mos adoptojë këto standarde, rishikime, dhe interpretime më parë datës së hyrjes në fuqi. Banka parashikon që adoptimi i këtyre standardeve dhe interpretimeve të rishikuara nuk do të ketë ndikim të konsiderueshëm në pasqyrat financiare të saj në periudhën e aplikimit fillestar.

(Të gjitha shifrat janë shprehur në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

3. Politika të rëndësishme kontabël

(a) Deklarata e përpuethshmërisë

Pasqyrat financiare individuale të Bankës janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

(b) Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike përveç investimeve të vlefshme për shitje të cilat janë paraqitur me vlerën e drejtë.

(c) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare individuale paraqiten në Lek, e cila është monedha funksionale e Bankës.

(d) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në Lek me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë raportimi, zërat monetarë të bilancit të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen në Lek me kursin në datën e raportimit.

Fitimi ose humbja nga ndryshimi i kurseve të këmbimit është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës të rregulluara me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të kthyer në monedhën funksionale me kursin e fundvitit. Aktivitet dhe detyrimet jo monetare në monedhë të huaj të cilat maten me vlerë të drejtë, konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së caktimit të vlerës së drejtë. Diferencat që lindin nga kurset e këmbimit regjistrohen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave

2. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(e) Interesi

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në bazë të metodës së interesit efektiv.

Norma e interesit efektiv është norma që skonton pagesat dhe arkëtimet e ardhshme monetare gjatë jetës së aktivitetit ose detyrimit financiar (ose kur është e përshtatshme një periudhë më e shkurtër) për t'i barazuar me vlerën kontabël të aktivitetit ose detyrimit financiar. Norma efektive e interesit vendoset duke marrë parasysh rrjedhjet e ardhshme të parave sipas kontratës por jo humbje të ardhshme krediti.

Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha komisionet e paguara ose të marra të cilat janë një pjesë përbërëse e normës efektive të interesit. Kostot e transaksioneve janë kosto shtesë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen ose emetimin e një aktivi apo detyrimi financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi të paraqitura në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave përfshijnë interesin mbi aktivet dhe detyrimet financiare me kosto të amortizuar mbi baza të interesit efektiv.

(f) Tarifa dhe Komisione

Të ardhurat dhe shpenzimet nga tarifat dhe komisionet, të cilat janë pjesë integrale e normës së interesit efektiv në një aktiv ose detyrim financiar përfshihen në matjen e normës së interesit efektiv.

Të ardhura të tjera nga komisionet dhe tarifat duke përmendur këtu tarifat e shërbimeve kontabël, komisionet e shitjeve, tarifa të depozitave njihen në momentin që ofrohen shërbimet e lidhura me to.

Shpenzime të tjera nga komisione dhe tarifa lidhen kryesisht me tarifa transaksionesh ose shërbimesh të cilat shpenzohen në momentin që shërbimet përfitohen.

(g) Pagesat e qerasë operative

Pagesat e bëra nën qeranë operative janë njohur në të ardhura dhe shpenzime në bazë të metodës lineare mbi jetëgjatësinë e qerasë. Zbritje nga qeraja njihen si pjesë përbërëse e totalit të shpenzimit të qerasë gjatë jetës së qerasë.

(h) Invesimi në filiale

Investimi në filiale kontabilizohet me kosto. Filialet janë njësi ekonomike të kontrolluara nga Banka. Kontrolli ekziston kur Banka ka fuqinë direkte ose indirekte të qeverisë politikat financiare dhe operative të një njësie dhe gjithashtu të marrë përfitimet nga ky aktivitet.

(i) Shpenzimet operative

Shpenzimet operative regjistrohen atëherë kur ato ndodhin.

(j) Planet e pensioneve me përfitim të përcaktuar

Kontributet e Bankës ndaj planit të pensioneve me kontribut të përcaktuar ngarkohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur ato ndodhin. Banka paguan kontribute për sigurimet shoqërore të detyrueshme për përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Autoritetet Shqiptare janë përgjegjëse për përcaktimin e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributësh të përcaktuara për pensione.

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(k) Tatim fitimi

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital. Në këto raste tatimi njihet si zë i kapitalit.

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi fitimin e tatueshëm të vitit duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që konsiderohet si e tillë në datën e mbylljes së pasqyrave financiare dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë është llogaritur duke përdorur metodën e pozicionit financiar, nga diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe bazës tatimore. Tatimi i shtyrë nuk njihet për diferencat e përkohshme si: njohjen fillestare të emrit të mirë, njohjen fillestare të aktiveve ose detyrimeve në një transaksion që nuk është një kombinim biznesi dhe që nuk ndikon as mbi fitimin kontabël dhe të tatueshëm, si dhe diferencave që lidhen me investimet në degë deri në masën që ato nuk nuk do të rikthehen në një të ardhme të parashikueshme. Tatimi i shtyrë matet me normat e taimit që pritet të aplikohen ndaj diferencave të përkohshme kur ato kthehen mbrapsht bazuar në ligjet që janë në forcë në datën e raportimit.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit diferencat e përkohshme të zbritshme të mund të përdoren. Tatimi i shtyrë rishikohet në çdo datë raportimi dhe zvogëlohet deri në masën që nuk ka më mundësi që përfitimi nga tatimi mund të realizohet.

Tatime të tjera mbi të ardhurat që rrjedhin nga shpërndarja e dividendëve njihen në të njëjtën kohë kur njihet detyrimi për të paguar dividendët përkatës.

(l) Aktivet dhe detyrimet financiare

(i) Njohja

Banka njih fillimisht huatë, parapagimet dhe depozitat me kosto në datën e origjinës. Të gjitha aktivet dhe detyrimet financiare të tjera fillimisht njihen në datën e tregëtimit, datë në të cilën Banka bëhet palë e kontratës.

(ii) Ç'regjistrimi

Aktivitetet financiare ç'regjistrohen nëse të drejtat kontraktuale të Bankës ndaj rrjedhjeve monetare që rrjedhin nga aktivi financiar mbarojnë ose nëse Banka i transferon aktivin financiar një pale tjetër bashkë me kontrollin ose të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivitetit. Çdo interes në aktive financiare të transferueshme që përfitohet ose mbahet nga Banka njihet si një aktiv ose detyrim më vete.

Detyrimet financiare ç'regjistrohen nga Banka nëse detyrimet e Bankës të detajuara në kontratë mbarojnë, janë shlyer ose janë anuluar.

Banka merr pjesë në transaksione me anë të të cilave transferon aktive të njohura në pozicionin financiar, por mban në të njëjtën kohë të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivitetit të transferuar, ose një pjesë të tyre.

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(I) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(ii) Ç'rregjistrimi (vazhdim)

Nëse të gjitha rreziqet dhe përfitimet mbahen, atëherë aktivet e transferuara nuk ç'rregjistrohen nga bilanci. Transferimi i aktiveve për të cilat mbahen të gjitha rreziqet dhe përfitimet përfshin huadhënien e letrave me vlerë dhe transaksionet e riblerjeve.

Në transaksione në të cilat Banka as nuk mban dhe as nuk transferon rreziqet dhe përfitimet e pronësise mbi aktivet financiare, e çregjistron aktivin nëse kontrolli mbi të humbet. Të drejtat dhe detyrimet e mbajtura në transferim janë të njohura më vetë si aktive ose detyrime sipas rastit. Në transferimet e aktiveve mbi të cilat mbahet kontrolli Banka vazhdon ta njohë aktivin deri në momentin e përfshirjes së saj të vazhdueshme, e përcaktuar kjo nga koha gjatë së cilës Banka është e ekspozuar ndaj ndryshimeve në vlerën e aktivit të transferuar.

Gjithashtu Banka i c' regjistron disa aktive kur keto balanca gjykohen si të parikuperueshme (shiko shënimin 4).

Kompensimi

Banka nuk kompenson aktive dhe detyrime ose të ardhura dhe shpenzime, të mos kërkohet ose lejohet nga SNRF. Gjithashtu, Banka paraqet në bazë neto fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga një grup i ngjashëm transaksionesh për shembull fitimet dhe humbjet nga këmbimet valutore. Megjithatë, Banka mund t'i paraqesë të tilla fitime ose humbje në mënyrë individuale në qoftë se ato janë materiale.

(iii) Matja e kostos së amortizuar

Kostoja e amortizuar e një aktivi ose detyrimi financiar është vlera me të cilën aktivi ose detyrimi njihet në momentin fillestar duke i zbritur pagesat e principalit, plus/minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferencë ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturitet, minus çdo zbritje për efekt zhvlerësimi.

(iv) Matja e vlerës së drejtë

Përkufizimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare mbështetet mbi çmimet e kuotuar të tregut ose çmimet e agjentëve të shitjes për instrumenta financiarë të tregëtueshme në tregje aktive. Për të gjitha instrumentat e tjerë financiarë vlera e drejtë përcaktohet mbi bazën e teknikave të vlerësimit. Metodën e vlerësimit përfshijnë teknikën e vlerës aktuale neto, metodën e rrjedhjeve monetare të skontuara, dhe krahasimin me instrumenta të tjerë të ngjashëm për të cilat ekzistojnë çmime tregu dhe metoda vlerësimi. Banka përdor gjerësisht metodat e vlerësimit për të përcaktuar vlerën e drejtë të instrumentave financiarë të zakonshëm e të thjeshtë si opsionet e normat e interesit dhe swap-e të monedhës. Për të tilla instrumenta të dhënat për tu përdorur në modelet e vlerësimit janë lehtësisht të vëzhgueshme në treg.

(v) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit

Në çdo datë raportimi Banka vlerëson nëse ka evidencë objektive që aktivet financiare të cilat nuk mbahen me vlerën e drejtë përmes fitim humbjes janë zhvlerësuar. Aktivet financiare zhvlerësohen kur evidenca objektive paraqet që një ngjarje që sjell humbje ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivit dhe që ngjarja që sjell humbje ka një ndikim në rrjedhjet e ardhshme të parasë së aktivit, të cilat mund të maten me besueshmëri. Banka i zhvlerëson aktivet e asaj individualisht dhe gjithashtu në grup. Të gjitha aktivet financiare të konsiderueshme trajtohen për zhvlerësim specifik. Të gjitha aktivet financiare të konsiderueshme që nuk trajtohen për zhvlerësim specifik trajtohen në grup për ndonjë zhvlerësim të ndodhur por të paidentifikuar ende.

Aktivitet të cilat nuk janë individualisht të konsiderueshme trajtohen së bashku për zhvlerësim duke u grupuar në aktive financiare (të mbajtura me kosto të amortizuar) me karakteristika të njëjta rreziku.

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(l) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(vi) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit (vazhdim)

Evidenca objektive që aktivet financiare janë të zhvlerësuara mund të përfshijnë mospagesa ose shkelje nga huamarrësit, ristrukturimin e nje huaje, të dhëna që nje huamarrës ose huadhënës po falimenton, zhdukjen e nje tregu aktiv për një letër me vlerë, ose të dhëna të tjera të dukshme lidhur me një grup aktivesh si psh ndryshime të pafavorshme të aftësive paguese të një huamarrësi ose huadhënësi ose kushtet ekonomike që tregojnë për mospagime.

Për trajtimin e zhvlerësimit kolektiv Banka përdor modelimin statistikor të trendeve historike të probabilitetit të mospagimit, përcaktimin e kohës së rekuperimit dhe vlerën e humbjes së ndodhur, përshtatur me gjykimin menaxherial nëse kushtet aktuale ekonomike dhe të kreditit janë të tilla që humbjet aktuale të jenë më të mëdha ose më të vogla se ato të përcaktuara nga modelimet historike. Normat e mospagimeve, normat e humbjes dhe përcaktimi i kohës së rekuperimit krahasohen përkundrejt rezultateve aktuale për të siguruar që ato të mbeten të duhurat.

Humbjet nga zhvlerësimi të aktiveve të mbajtura me kosto të amortizuar llogariten si diferencë e vlerës kontabël të aktiveve financiare dhe vlerës aktuale të rrjedhjeve monetare të skontuara me vlerën origjinale të interesit efektiv të këtyre aktiveve. Humbjet njihen në pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve dhe pasqyrohen në një llogari provigjoni përkundrejt huave dhe parapagimeve. Interesat mbi aktivet e zhvlerësuara vazhdojnë të njihen nëpërmjet skontimeve të pandryshueshme. Kur një ngjarje pas datës së bilancit shkakton uljen e humbjes nga zhvlerësimi, humbja nga zhvlerësimi pasqyrohet në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave.

(m) Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë kartëmonedha, monedha, gjëndje të pakushtëzuara të Bankës Qëndrore, llogari rrjedhëse dhe depozita me afat maturimi më pak se tre muaj, të cilat nuk ndikohen shumë nga ndryshimet në vlerën e drejtë dhe përdoren nga Banka për administrimin e angazhimeve afatshkurtra.

(n) Huatë dhe paradhëniet

Huatë dhe paradhëniet janë aktive financiare jo-derivativë, me pagesa fikse ose të përcaktueshme, të cilat nuk janë kuotuar në tregje aktive dhe Banka nuk ka për qëllim t'i shesë në periudhë afatshkurtër.

Kur Banka blen një aktiv financiar dhe njëherësh hyn në një marrëveshje për ta rishitur këtë aktiv (ose një aktiv kryesisht të ngjashëm) me një çmim të fiksuar në një datë të ardhshme (marrëveshje të anasjellta të riblerjes), marrëveshja kontabilizohet si një hua apo paradhënie dhe aktivet në bazë të marrëveshjes nuk paraqiten në pasqyrat financiare të Bankës.

Huatë dhe paradhëniet fillimisht maten me vlerë të drejtë plus kosto direkte transaksioni dhe në vazhdim maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

(o) Letrat me vlerë

Investimi në letra me vlerë matet me vlerën e tregut duke i shtuar kostot direkte të transaksionit dhe në vijim të kontabilizuara mbi bazën e klasifikimit si të mbajtura deri në maturim, me vlerë të drejtë përmes pasqyrës përmbledhëse të të ardhurave ose të mbajtura për shitje.

(i) Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim

Letrat me vlerë që mbahen deri në maturim përfshijnë bono thesari dhe obligacione të qeverisë. Investimet që kanë pagesa fikse ose të përcaktuara dhe të cilat kanë për qëllim të mbahen deri në maturim regjistrohen më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Çdo shitje ose riklasifikim i shumave të konsiderueshme të investimeve të mbajtura deri në maturim, jo shumë afër maturimit do të çonte në riklasifikimin e të gjithë portofolit të mbajtur deri në maturim si investim i mbajtur për shitje dhe do ndalonte Bankën për klasifikimin e tyre si investim i mbajtur deri në maturim për periudhen aktuale dhe për dy vitet pasuese.

3. Politikave kontabël (vazhdim)

(o) Letrat me vlerë (vazhdim)

(ii) *Letrat me vlerë të vlefshme për shitje*

Investime të vlefshme për shitje janë investime jo-derivative të cilat nuk klasifikohen në ndonjë kategori tjetër të aktiveve financiare.

Investimet në kapital të cilat nuk janë të kuotuar dhe vlera e drejtë nuk mund të matet në mënyrë të besueshme por me kosto. Mjetet e tjera të vlefshme për shitje mbahen në pasqyrat financiare me vlerën e drejtë të tyre. Të ardhurat nga interesi regjistrohen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave sipas metodës së interesit efektiv. Të ardhurat/humbjet nga këmbimet valutore të letrave me vlerë të vlefshme për shitje regjistrohen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave.

Ndryshimet në vlerën e drejtë njihen direkt në kapital deri në momentin që letra me vlerë shitet ose zhvlerësohet dhe vlera e njohur në kapital, kalon si fitim ose humbje në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave.

(p) Aktivet e trupëzuara

(i) *Njohja dhe matja*

Zërat e aktiveve afatgjata materiale paraqiten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë.

Kosto përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të ngarkueshme për blerjen e aktivit. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë shoqëria përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore, si dhe ndonjë kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me vënien e aktivit në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar nga drejtimi dhe kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit dhe kthimit të vendndodhjes në kushtet e duhura. Kur pjesë të një elementi të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të dobishme të ndryshme kontabilizohen si elementë të veçanta të aktiveve afatgjata materiale.

(ii) *Kostot vijuese*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbartur të elementit nëse është e mundshme që përfitime ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij elementi do të rrjedhin në Bankë, dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave në momentin kur ndodhin.

(iii) *Zhvlerësimi*

Zhvlerësimi njihet në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave me anën e metodës lineare gjatë jetës së cdo aktivit të trupëzuar. Aktivet e marra me qera zhvlerësohen për më të shkurtrën midis kohës së qerasë dhe jetëgjatësisë së aktivit.

Jetëgjatësia për periudhën aktuale dhe atë krahasuese është si vijon:

	(në vite)
Ndërtesa	50
Kompjutera dhe pajisje informatike	5
Instalime dhe pajisje të tjera	5
Pajisje zyre	10
Automjete	7
Investime në mjetet marrë me qera	5

Jetëgjatësia dhe vlera e mbetur rishikohen në datën e raportimit. Zhvlerësimi nuk llogaritet për aktivet në proces.

3. Politika kontabël (vazhdim)

(q) Aktivet e patrupëzuara

Programet kompjuterike të blera nga Banka njihen me koston historike zvogëluar me amortizimin dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë.

Shpenzimet e mëtejshme mbi programet kompjuterike kapitalizohen vetëm kur këto shpenzime lidhen me rritjen e përfitimit të ardhshëm ekonomik prej këtij aktivi. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në periudhën që ndodhin tek pasqyra përmbledhëse e të ardhurave.

Shpenzimi i amortizimit njihet në pasqyrën e të ardhurave, bazuar mbi metodën lineare të amortizimit gjatë jetës së dobishme ekonomike, prej datës në të cilën ky program është i gatshëm për përdorim. Jeta e dobishme ekonomike e programeve kompjuterike është dhjetë vjet.

(r) Aktive fikse të mbajtura për shitje

Aktive të tjera fikse konsiderohen të mbajtura për shitje në qoftë se vlera e tyre kontabël do të rimerret kryesisht nëpërmjet një transaksioni shitje sesa duke vazhduar përdorimin e tyre. Aktive të tjera fikse të mbajtura për shitje maten me vlerën më të ulët ndërmjet vlerës kontabël dhe vlerës së drejtë minus koston e shitjes.

(s) Rënia në vlerë e aktiveve jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Bankës, përveç aktiveve tatimore të shtyra rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për zhvlerësim. Nëse ka evidenca të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit.

Humbje nga rënia në vlerë njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon vlerën e rikuperueshme. Njësia gjeneruese e mjeteve monetare është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron rrjedhje monetare që janë të pavarura nga aktivet dhe grupet e tjera. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është më e madhja ndërmjet çmimit neto të shitjes dhe vlerës së tij në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, rrjedhjet e çmuara të ardhshme të mjeteve monetare janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregjeve për vlerën në kohë të parasë dhe risqet specifike për aktivin..

Humbjet e mëparshme rishikohen për të vlerësuar nëse rënia në vlerë është zbutur. Një humbje anulohet nëse ka evidencë se nuk ka zhvlerësim dhe ka patur ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga rënia në vlerë anulohet deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivitetit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin dhe sikur të mos ishte njohur ndonjë humbje nga rënia në vlerë.

(t) Depozita dhe detyrime të tjera financiare

Depozitat dhe detyrimet e tjera financiare janë burimet kryesore të financimit të Bankës.

Kur Banka shet një aktiv financiar dhe hyn në një marrëveshje ri-blerjeje për ta blerë këtë aktiv (ose një aktiv të ngjashëm) me një çmim fiks në të ardhmen, marrëveshja kontabilizohet si një depozitë, dhe aktivi vazhdon të njihet në pasqyrat financiare të Bankës.

Banka klasifikon instrumentet kapitale si detyrime financiare ose instrumenta kapitale në përputhje me thelbin e kushteve kontraktuale të instrumentit.

Depozitat dhe detyrimet e tjera financiare maten fillimisht me vlerën e tregut duke i shtuar kostot e transaksionit dhe në vijim maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

(u) Provigjon

Një provigjon njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve të mëparshme, Banka ka një detyrim ligjor ose konstruktiv i cili mund të matet në mënyrë të besueshme dhe është e mundur që të mirat ekonomike do të kërkohen për shlyerjen e këtij detyrimi. Provigjonet caktohen duke skontuar rrjedhjet e pritshme të parave me një normë para takse e cila reflekton vlerën e tregut dhe nëse është e përshtatshme rrezikun specifik të detyrimit.

4. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Drejtimi i Bankës ka diskutuar me Bordin Drejtues zhvillimin, zgjedhjen dhe paraqitjen e politikave dhe vlerësimeve kritike kontabël të Bankës dhe aplikimin e këtyre politikave dhe vlerësimeve. Vlerësimet dhe supozimet që lidhen me to rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar në qoftë se rishikimi prek vetëm atë periudhë ose në periudhën e rishikimit dhe periudhat e ardhshme nëse rishikimi ndikon njëkohësisht në periudhën raportuese dhe në periudhat e ardhshme. Këto shënime shpjeguese mbështesin komentet mbi administrimin e rrezikut financiar (shiko shënimin 29).

Burimet kryesore të pasigurisë në matje

Fonde të lejuara për humbje nga kreditë

Përbërësi specifik në totalin e fondit të zhvlerësimit të aktiveve financiare të vlerësuara individualisht, bazohet në vlerësimin më të mirë të rrjedhjeve të pritshme të parasë. Për të llogaritur këto rrjedhje të parave drejtimi i Bankës gjykon mbi situatën financiare të palës tjetër dhe vlerën neto të realizueshme të ndonjë garancie. Çdo aktiv i zhvlerësuar matet bazuar mbi cilësitë e tij dhe llogaritja e rrjedhjeve të parasë që konsiderohen të arkëtueshme aprovohet në mënyrë të pavaruar nga rreziku i kredisë.

Fondi i zhvlerësimit të portofolit mbulon humbje nga kreditë dhënë klientëve me karakteristika ekonomike të ngjashme, kur nuk ka ndonjë evidencë të dukshme për humbje, por humbja mund të ketë ndodhur dhe pse e paidentifikueshme në datën e pasqyrave.

Një element i fondit kolektiv për zhvlerësimin e kredive është rreziku i vendit ku është dhënë kredia. Në vlerësimin e nevojës për fond kolektiv drejtimi konsideron faktorë si cilësia e kreditimit, madhësia e portofolit, përqëndrimin si dhe faktorë ekonomik. Në mënyrë që të vlerësohet fondi i kërkuar janë bërë supozime për të përcaktuar sesi janë modeluar humbjet dhe për të përcaktuar parametrat e kërkuar bazuar në të kaluarën ose nga kushtet aktuale ekonomike. Saktësia e vlerësimit të fondit kolektiv të zhvlerësimit varet nga sa të matshme janë rrjedhjet e ardhshme të projektuara dhe supozimet dhe parametrat e përdorura në modelin e vlerësimit

Përcaktimi i vlerës së drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë për aktivet financiare dhe detyrimet për të cilat nuk ka një çmim tregu të monitorueshëm kërkon përdorimin e teknikave të vlerësimit siç përshkruhen në politikën kontabël 3(m)(iv). Për instrumentët financiarë që kanë treg financiar, por jo aktiv dhe çmimi i tregut nuk është transparent mjaftueshëm vlera është më pak objektive dhe kërkon shkallë variabël gjykimi në varësi të likuiditetit, përqëndrimit, pasigurisë e faktorëve të tregut, supozime rreth çmimit dhe rreziqe të tjera që ndikojnë mbi instrumentin specifik.

Vlerësimi dhe paraqitja e vlerës së drejtë

Vlerësimet e vlerës së drejtë bazohen në instrumentat financiarë të bilancit ekzistues pa u përpjekur të përcaktojnë vlerën e biznesit të pritshëm dhe vlerën e aktiveve dhe detyrimeve që nuk konsiderohen instrumenta financiarë.

Hua dhe paradhënie bankave dhe institucioneve financiare

Huatë dhe paradhëniet dhënë bankave përfshijnë vendosjet ndërbankare. Vlera e tyre e drejtë konsiderohet të jetë përafërsisht e njëjtë me vlerën e tyre kontabël.

Hua dhe paradhënie klientëve

Huatë dhe paradhëniet paraqiten neto nga diferenca e vlerës së tyre bruto me fondin e zhvlerësimit. Portofoli i huave të bankës ka një vlerë të drejtë të përafërt me vlerën e tyre kontabël për shkak ose të natyrës së tyre afat-shkurtër ose të normave të interesit, të cilat i përafrohen atyre të tregut. Pjesa më e madhe e portofolit të huave është subjekt i ricimit brenda një viti.

Detyrime të jera ndaj bankave dhe klientëve

Vlera e drejtë e përcaktuar e depozitave me maturim të pa përcaktuar, që përfshin depozitat që nuk mbartin interes është shuma e ripagueshme me t'u kërkuar.

5. Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e saj më 31 dhjetor 2009 janë të detajuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2009	31 dhjetor 2008
Arka		
Në Lek	308,987	476,966
Në monedhë të huaj	425,807	515,743
Llogari rrjedhëse me Bankën Qendrore	146,040	51,850
Llogari rrjedhëse me Bankat	25,480	234,152
Vendosjet në tregun e parasë	885,698	1,511,949
Total	1,792,012	2,790,660

Norma e interesit vjetor për depozitat me afat me bankat rezidente në 31 dhjetor 2009 variojnë nga 3.3% në 6.8% (2008: 4.5% në 7.5%) dhe për depozitat me afat me bankat jo-rezidente nga 0.1% në 2.6% (2008: 1.5% në 3%).

(Të gjitha shifrat janë shprehur në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

Llogaritë rrjedhëse me bankat në 31 Dhjetor 2009 të detajuara gjeografikisht janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2009	31 dhjetor 2008
Gjermani	16,791	254
Austri	8,059	51,644
Itali	376	594
Shtetet e Bashkuara të Amerikës	165	-
Parisi	89	(22,272)
Londra	-	203,930
Shqipëri	-	2
Totali	25,480	234,152

Vendosjet në tregun e parasë në 31 dhjetor 2009 të detajuara gjeografikisht janë si më poshtë dhe maturiteti i tyre varion nga 5-8 ditë:

	31 dhjetor 2009	31 dhjetor 2008
Austri	646,151	316,358
Shqipëri	239,547	553,574
Itali	-	456,254
Francë	-	185,763
Totali	885,698	1,511,949

6. Shumat e kushtëzuara me Bankën Qëndrore

Në përputhje me kërkesat e Bankës Qëndrore lidhur me depozitën rezervë, Banka duhet të mbajë një minimum prej 10% të depozitave të klientëve pranë Bankës Qëndrore si llogari rezervë. Rezerva statutore nuk është e disponueshme për operacionet e përditshme të Bankës.

Interesat mbi rezervën statusore në Bankën Qëndrore janë llogaritur si më poshtë:

- LEK: 70% mbi normat e marrëveshjeve të riblerjes: 4.03% në vit për 31 dhjetor 2009 (31 dhjetor 2008: 4.375% në vit);
- USD: 70% mbi normën një-vjetore LIBOR në USD : 0.69% në 31 dhjetor 2009 (31 dhjetor 2008: 0.7% në vit);
- EUR: 70% mbi normën një-vjetore LIBOR në EUR: 0.85% në 31 dhjetor 2009 (31 dhjetor 2008: 2.28% në vit).

7. Hua dhe parapagime ndaj institucioneve financiare

Huatë dhe parapagimet ndaj institucioneve financiare më 31 dhjetor 2009 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2009	31 dhjetor 2008
Hua ndaj institucionit financiar	201,752	247,265
Llogari escrow për garanci bankare	38,722	39,080
Totali	240,474	286,345

Hua ndaj insitucionit financiar përfaqëson një hua me maturitet kontraktual prej 3 vjetësh dhe fiton interes prej 10.2 % në vit.

8. Investime të vlefshme për shitje

Investimet të vlefshme për shitje në 31 dhjetor 2009 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2009	31 dhjetor 2008
Bono Thesari (8.1)	7,491,281	9,455,455
Obligacione Qeveritare (8.2)	7,341,400	7,257,429
Totali	14,832,681	16,712,884

(Të gjitha shifrat janë shprehur në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

8. Investime të vlefshme për shitje (vazhdim)

8.1 Bono Thesari

Bonot e Thesarit sipas maturimit kontraktual detajohen si më poshtë:

				31 dhjetor 2009
Maturimi	Vlera e tregut		Interesi i përlogaritur	Vlera e mbartur
3 muaj	294,604		237	294,841
6 muaj	680,660		14,930	695,590
12 muaj	6,317,029		183,821	6,500,850
	7,292,293		198,988	7,491,281

				31 dhjetor 2008
Maturimi	Vlera e tregut		Interesi i përlogaritur	Vlera e mbartur
3 muaj	1,971		8	1,979
6 muaj	892,539		20,156	912,695
12 muaj	8,264,605		276,176	8,540,781
	9,159,115		296,340	9,455,455

Norma efektive e interesit e Bonove të Thesarit më 31 dhjetor 2009 luhatej ndërmjet 6.24% to 9.45% (31 dhjetor 2008: nga 6.24% në 8.74%).

8.2 Obligacione Qeveritare

Obligacionet Qeveritare në 31 dhjetor 2009 janë të detajuara si më poshtë:

					31 dhjetor 2009
Maturimi	Çmimi i blerjes	Vlera e tregut	Interesi i përlogaritur		Vlera e mbartur
24 muaj	5,246,476	5,249,505	105,458		5,354,963
36 muaj	595,730	597,053	19,213		616,266
60 muaj	1,352,325	1,336,193	33,978		1,370,171
	7,194,531	7,182,751	158,649		7,341,400

31 dhjetor 2008				
Maturimi	Çmimi i blerjes	Vlera e tregut	Interesi i përlogaritur	Vlera e mbartur
24 muaj	5,093,825	5,105,545	100,454	5,205,999
36 muaj	595,730	603,636	18,949	622,585
60 muaj	1,352,326	1,396,367	32,478	1,428,845
	7,041,881	7,105,548	151,881	7,257,429

Obligacionet Qeveritare përfitojnë interes gjashtë mujor me një normë kuponi në 31 dhjetor 2009 ndërmjet 8.25% deri në 10.53% (31 dhjetor 2008: nga 7.95% deri në 10.17%).

(Të gjitha shifrat janë shprehur në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

9. Hua dhe paradhënie për klientët, neto

Huatë dhënë klientëve në 31 Dhjetor 2009 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2009	31 dhjetor 2008
Sipërmarrës privat dhe ndërmarrje	9,225,791	6,494,327
Individë	7,530,404	6,708,334
	16,756,195	13,202,661
Minus provigjon për zhvlerësim	(750,902)	(285,642)
Totali	16,005,294	12,917,019

Huatë ndaj klientëve, neto në 31 dhjetor 2009 përfshijnë overdrafte në shumën prej 4,086,726 mijë Lek (31 dhjetor 2008: 2,982,434 mijë Lek).

Lëvizjet në provigjoni për zhvlerësim në 31 dhjetor 2009 janë si më poshtë:

	2009	2008
Shuma në fillim të vitit	285,642	176,499
Provigjoni për zhvlerësimin e huave	465,260	109,143
Shuma në fund të vitit	750,902	285,642

Gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2009 si përgjigje e eksperiencës dhe historisë në rritje mbi të cilën supozimet ishin bazuar Banka rishikoi metodologjinë e saj të zhvlerësimit për huatë ndaj klientëve. Rishikimet u kontabilizuan në mënyrë prospektive si ndryshim në vlerësimet kontabël dhe si rrjedhim fondi i zhvlerësimit të huave për klientët për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2009 u rrit me 241,636 mijë Lek.

10. Huaja për Qeverinë e Shqipërisë

Gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2009, Banka u bë pjesë e një sindikate bankash të udhëhequr nga Deutsche Bank për financimin e Qeverisë së Shqipërisë. Shuma totale e financimit është 250 milion Euro dhe përbëhet nga (i) Lehtësia Kredituese A në shumën EUR 95 milion dhe (ii) Lehtësia Kredituese B në shumën 155 milion Euro. Banka mori pjesë në Lehtësinë Kredituese B duke financuar 10 milion Euro me një normë interesi Euribor 6-mujor plus 9.65%, me një afat 3-vjecar deri në datë 3 korrik 2012 disbursuar më datë 3 korrik 2009. Më 31 dhjetor 2009 teprica e huasë dhënë Qeverisë së Shqipërisë rezulton në shumën 1,454,864 mijë Lek.

11. Aktivet e trupëzuara, neto

Kosto	Kompjuterat dhe pajisje elektronike			Investime në ambiente me qera			Totali
	Ndërtesa	Mobilje dhe pajisje zyre	Automjete	Investime në ambiente me qera	Punime në proces		
Në 1 janar 2008	130,488	270,703	33,680	119,835	135,123		888,484
Shtesa	39,273	95,539	5,266	64,056	155,092		492,112
Pakësime	-	(8,165)	-	-	-		(10,670)
Në 31 dhjetor 2008	169,761	358,077	38,946	183,891	290,214		1,369,926
Shtesa	7,490	56,030	6,490	37,446	22,548		210,201
Pakësime	-	(122)	-	(7,499)	-		(7,621)
Transferime	95,369	-	-	-	(95,369)		-
Në dhjetor 2009	272,620	413,985	45,436	213,838	217,395		1,572,506
Zhvlërësimi i kumuluar							
Në 1 janar 2008	(3,282)	(86,095)	(4,085)	(60,047)	-		(252,609)
Shtesa e vitit	(3,192)	(38,058)	(7,047)	(27,574)	-		(124,371)
Pakësime	-	2,670	-	-	-		4,117
Në 31 dhjetor 2008	(6,474)	(121,483)	(11,132)	(87,621)	-		(372,863)
Shpenzimi i vitit	(5,307)	(48,822)	(8,098)	(37,429)	-		(159,396)
Pakësime	-	89	-	3,746	-		3,835
Në 31 dhjetor 2009	(11,781)	(170,216)	(19,230)	(121,304)	-		(528,424)
Vlera e mbetur neto							
Në 31 dhjetor 2008	163,287	236,594	27,814	96,270	290,215		997,063
Në 31 dhjetor 2009	260,839	243,769	26,204	92,534	217,394		1,044,082

(Të gjitha shifrat janë shprehur në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

12. Aktivet e patrupëzuara, neto

	Programe kompjuterike
Kosto	
Në 1 janar 2008	28,982
Shtesa	3,841
Në 31 dhjetor 2008	32,823
Shtesa	268,236
Pakësime	(35,824)
Në 31 dhjetor 2009	265,235
Amortizimi i akumuluar	
Në 1 janar 2008	(24,517)
Shpenzimi i vitit	(3,443)
Në 31 dhjetor 2008	(27,960)
Shpenzimi i vitit	(4,103)
Pakësime	22,545
Në 31 dhjetor 2009	(9,518)
Vlera e mbetur neto	
Në 31 dhjetor 2008	4,863
Në 31 dhjetor 2009	225,717

Shtesat në aktivet e patrupëzuara gjatë vitit 2009 përbëhen nga kapitalizimi i shpenzimeve për sistemin bazë informatik të bankës "Delta Software".

13. Aktive fikse të mbajtura për shitje

Më 31 dhjetor 2009 aktivet fikse të mbajtura për shitje prej 78,742 thousand mijë Lek (31 dhjetor 2008: 2,800 mijë Lek) përfaqësojnë aktive të përfituara nga huatë e humbura në formë kolaterali të cilat janë në përmbarrim ose në ekzekutim.

14. Aktivet e tjera

Aktivitet e tjera në 31 dhjetor 2009 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2009	31 dhjetor 2008
Debitorë	67,763	37,282
Parapagime	45,398	10,551
Llogari kleringu	2,863	49,492
Transaksione si agjent	-	954
Totali	116,024	98,279

15. Investimi në filiale

Investimi në filiale përfaqëson një shumë prej 100,000 mijë Lek të paguar si kapital i nënshkruar gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2009 për një investim të mbajtur 100% në "Sogelease Albania" sh.a. aktiviteti i së cilës është qeraja financiare.

(Të gjitha shifrat janë shprehur në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

16. Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare

Detyrimet ndaj institucioneve financiare në 31 dhjetor 2009 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2009	31 dhjetor 2008
Marrëveshje riblerje me Bankën e Shqipërisë	1,599,644	1,907,262
Depozita	783,945	352,190
Llogari rrjedhëse	127,692	29,668
Hua nga bankat	8,967	699,748
Totali	2,520,248	2,988,868

Marrëveshjet e riblerjes me Bankën e Shqipërisë në 31 dhjetor 2009 kanë një normë interesi 5.75% në vit. (31 dhjetor 2008: norma e interesit 6.25% në vit).

Vlera e mbartur e Bonove të thesarit të vendosura si kolateral sipas marrëveshjeve të riblerjeve është 1,870,000 Lek.

Depozitat me afat dhe llogaritë rrjedhëse lidhen me shumatat me institucionet financiare, kryesisht me kompani sigurimi duke përfshirë fondet garantuese që janë të detyruara të mbajnë me bankat tregtare. Depozitat me afat në 31 dhjetor 2009 mbartin një normë interesi që luhetet nga 3.5% në 6.89% në vit (31 dhjetor 2008: nga

4.7% deri në 7.4% në vit) për Lekun, nga 0.23% deri në 0.60% në vit (31 dhjetor 2008: nga 0.1% deri në 1.7% vit) për USD, dhe nga 0.40% deri në 5.86% në vit (31 dhjetor 2008: nga 0.1% në 5.86% në) për Euro-n.

Huatë nga bankat në 31 dhjetor 2009, përbëhen nga një hua 5 ditore në Euro nga Societe Generale Paris në shumën prej 8,967 mijë Lek (31 dhjetor 2008: 619,748 mijë Lek) me një normë interesi 0.45% në vit (31 dhjetor 2008: 3.30% në vit)

17. Detyrime ndaj klientëve

Detyrimet ndaj klientëve në 31 dhjetor 2009 nga sa më poshtë:

	31 dhjetor 2009			31 dhjetor 2008		
	Monedha vendase	Monedha e huaj	Totali	Monedha vendase	Monedha e huaj	Totali
Llogari rrjedhëse						
Individë	1,148,524	824,051	1,972,575	956,116	768,297	1,724,413
Shoqëri private	835,842	608,190	1,444,032	927,694	478,662	1,406,356
Shoqëri publike	117,398	16,031	133,429	234,113	17,600	251,713
Administrata publike	16	36,005	36,021		46,021	46,021
	2,101,780	1,484,277	3,586,057	2,117,923	1,310,580	3,428,503
Depozita pa afat						
Individë	271,889	329,351	601,240	205,796	152,111	357,907
Shoqëri private	186,038	27,463	213,501	1,743	38,677	40420
	457,927	356,814	814,741	207,539	190,788	398,327
Depozita me afat						
Individë	17,946,963	8,174,494	26,121,457	17,520,775	6,280,866	23,801,641
Shoqëri private	195,555	183,055	378,610	730,841	772,593	1,503,434
Shoqëri publike	105,908	1,596	107,504	31,440	1,362	32,802
	18,248,426	8,359,145	26,607,571	18,283,056	7,054,821	25,337,877
Llogari të tjera						
Individë	2,161	16,968	19,129	3,291	8,644	11,935

(Të gjitha shifrat janë shprehur në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

Shoqëri private	25,295	18,826	44,122	27,439	12,280	39,719
Shoqëri publike	34	-	34	34	3	37
	27,490	35,794	63,284	30,764	20,927	51,691
Interesi i përllogaritur	567,391	115,231	682,622	579,036	100,849	679,885
Totali	21,403,014	10,351,261	31,754,275	21,218,318	8,677,965	29,896,283

Llogaritë rrjedhëse dhe depozitat pa afat kanë një normë interesi prej 0.1% në vit. Depozitat me afat kanë një normë interesi në 31 dhjetor 2009 që luhet nga 4.89% deri në 6.82% në vit (31 dhjetor 2008: nga 4.5% deri në 8.6% në vit) për Lekun dhe nga 3.6% deri në 4.54% (31 dhjetor 2008: nga 1.5% deri në 6.46% në vit) për monedhat e huaja. Llogaritë e tjera të klientëve përfaqësojnë llogari garantuese prej 63,284 mijë Lek (2008: 51,691 mijë Lek). Në 31 dhjetor 2009 dhe 31dhjetor 2008 këto llogari nuk kanë interes.

17. Detyrimet ndaj klientëve (vazhdim)

	31 dhjetor 2009	31 dhjetor 2008
Një mujore:		
Në monedhë të huaj	910,392	882,681
Në monedhë vendase	734,997	709,392
	1,645,389	1,592,073
Tre mujore:		
Në monedhë të huaj	1,369,113	1,405,388
Në monedhë vendase	1,712,866	1,391,568
	3,081,979	2,796,956
Gjashtë mujore:		
Në monedhë të huaj	1,280,156	844,750
Në monedhë vendase	2,534,118	2,267,712
	3,814,274	3,112,462
Një vjeçare:		
Në monedhë të huaj	4,060,156	3,451,443
Në monedhë vendase	11,896,980	12,449,145
	15,957,136	15,900,588
Dy vjeçare:		
Në monedhë të huaj	244,402	217,870
Në monedhë vendase	1,000,621	1,143,495
	1,245,023	1,361,365
Tre vjeçare:		
Në monedhë të huaj	494,927	252,689
Në monedhë vendase	368,844	321,744
	863,771	574,433
Totali	26,607,571	25,337,877

(Të gjitha shifrat janë shprehur në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

18. Tatimi i shtyrë pasiv

Lëvizjet në tatimin e shtyrë paraqiten si më poshtë:

	2009	2008
Detyrimi në fillim të vitit	49,718	35,476
I njohur në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave e	(17,455)	14,242
Detyrimi në fund të vitit	32,263	49,718

18. Tatimi i shtyrë pasiv (vazhdim)

Në 31 dhjetor 2009 dhe 31 dhjetor 2008 tatimi i shtyrë aktiv dhe pasiv i përket zërave të mëposhtëm:

	31 dhjetor 2009	31 dhjetor 2008
Tatimi i shtyrë aktiv		
Komisionet e shtyra	9,942	9,768
Aktive të tjera të njohura si shpenzim	2,645	2,091
Zhvlerësimi i aktiveve jo në përdorim	1,273	1,055
Kostot fillestare të njohura si shpenzim	430	750
Humbja tatimore e mbartur	-	35,049
Tatimi i shtyrë pasiv		
Provizjione për rënien në vlerë të aktiveve financiare	(46,553)	(98,431)
Tatimi i shtyrë neto pasiv	(32,263)	(49,718)

Tatimi i shtyrë aktiv është regjistruar neto nga tatimi i shtyrë pasiv meqë shumat janë si rrjedhojë e të njëjtit autoritet tatimor dhe parashikohen të mbyllen neto. Lëvizjet në diferencat e përkohshme gjatë vitit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Tatimi i miratuar për vitin 2009 është 10% (31 dhjetor 2008: 10%).

19. Detyrime të tjera

Detyrimet e tjera në 31 dhjetor 2009 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2009	31 dhjetor 2008
Llogari të pagueshme të përlogaritura	123,346	128,816
Llogari kleringu	82,195	243,691
Tatime të pagueshme	8,482	11,492
Kreditorë të tjerë	34,411	673
Total	248,434	384,672

Llogari të pagueshme të përlogaritura më 31 dhjetor 2009 përfshijnë shuma të pagueshme për ujë, energji kancelari, sigurime dhe shpenzime të tjera të ngjashme.

20. Kapitali aksioner

Kapitali i paguar përfaqëson aksionet e paguara dhe nënshkruara plotësisht nga aksionerët e Bankës.

Gjatë vitit 2009 aksionerët e bankës nënshkruan rritjen e kapitalit me 1,732,900 mijë Lek e përbërë nga 17,239 aksione të reja me vlerë nominale prej 100 mijë Lek secili. Kjo rritje kapitali është paguar në vlerën prej 1,516,450 mijë Lek nga Societe Generale që zotëron 75.01% të aksioneve dhe pjesa tjetër prej 216,450 mijë Lek mbetet për tu paguar nga aksionerët e tjerë. Në 31 dhjetor 2009 kapitali i paguar konsiston në shumën 4,449,450 mijë Lek (31 dhjetor 2008: 2,933,000 mijë Lek) sic detajohet më poshtë:

	Numri i aksioneve	Kapitali aksioner
Gjendja në 1 janar 2008	29,330	2,933,000
Ndryshimet gjatë vitit	-	-
Gjendja në 31 dhjetor 2008	29,330	2,933,000
Aksione të emetuara gjatë viti	17,329	1,516,450
Gjendja në 31 dhjetor 2009	46,659	4,449,450

(Të gjitha shifrat janë shprehur në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

	31 dhjetor 2009		31 dhjetor 2008	
	Numri i aksioneve	(%)	Numri i aksioneve	(%)
Societe Generale	35,000	75.01	22,000	75.01
Z. Vasil Naçi	4,451	9.53	2,798	9.54
Z. Kosta Sotiri	2,551	4.91	1,439	4.91
Z. Kristo Naçi	2,289	5.47	1,603	5.47
Z. Behar Male	712	1.53	449	1.53
Z. Guxim Resuli	475	1.02	298	1.02
Z. Lefter Sota	475	1.02	298	1.02
Z. Vladimir Kosta	469	1.00	296	1.00
Z. Adrian Doçi	237	0.51	149	0.51
Totali	46,659	100	29,330	100

21. Të ardhurat nga interesi

Të ardhurat nga interesi janë fituar nga aktivet si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2009	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2008
Hua dhënë klientëve	1,448,384	1,274,117
Investime të gatshme për shitje dhe marrëveshje riblerje	1,262,904	1,296,334
Hua dhe parapagime bankave	121,279	247,166
Hua dhënë Qeverisë Shqiptare	62,463	-
Amortizimi i zbritjes së obligacioneve	2,628	5,837
Totali	2,897,658	2,823,454

22. Shpenzime interesi

Shpenzimet e interesave në 31 dhjetor 2009 kanë ndodhur nga detyrimet si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2009	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2008
Detyrime ndaj klientëve	1,534,977	1,464,551
Hua dhe parapagime nga institucionet financiare	121,232	54,237
Amortizimim i primit të obligacioneve	349	1,749
Totali	1,656,558	1,520,537

23. Shpenzime personeli

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2009	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2008
Paga	417,017	360,105
Sigurime shoqërore	54,166	48,022
Bonuse dhe shpërblime	118,060	53,407
Totali	589,243	461,534

(Të gjitha shifrat janë shprehur në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

24. Shpenzime të përgjithshme administrative

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2009	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2008
Shpenzime qeraje	210,667	176,872
Komunikim dhe energji elektrike	119,176	97,304
Asistencë teknike nga mëma	81,582	27,740
Shërbime nga jashtë	71,384	72,055
Reklamë dhe promocion	71,764	85,514
Depozita dhe shpenzime të tjera sigurimi	77,769	79,342
Kancelari dhe printime	42,364	40,096
Mirëmbajtje dhe riparime	34,104	28,119
Udhëtime dhe transport	22,795	15,716
Shpenzime trajnimi	12,122	9,332
Shpenzime ligjore	8,613	5,822
Tatime të tjera përveç tatim fitimit	5,214	3,236
Shpenzime për auditorët e jashtëm	6,651	3,000
Bordi i Drejtorëve dhe Komiteti i Auditit	3,527	4,552
Shpenzime të tjera	5,023	1,896
Totali	772,755	650,596

Shërbimet e jashtme përfaqësojnë shpenzime për sigurinë, auditimin, ujë dhe energji elektrike etj.

25. Tatimi mbi fitimin

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2009	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2008
Tatimi aktual	-	-
Tatimi i shtyrë (e ardhur) / shpenzim	(17,455)	14,242
Totali	(17,455)	14,242

Tatimi mbi fitimin në Shqipëri matet me normën 10% (2008: 10%) të të ardhurave të tatueshme.

Më poshtë paraqitet rakordimi i tatimit të llogaritur me normën e aplikueshme të tatimit me fitimin kontabël në 31 dhjetor 2009:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2009	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2008
(Humbja) / Fitimi para tatimit	(517,328)	53,515
Diferenca të përkohshme		
Humbje nga dëmtimi	(204,433)	(518,786)
Rivlerësimi i kapitalit dhe të tjera	(120,382)	-
Kosto të nisjes rregjistruar si shpenzime	(3,218)	(3,218)
Zhvlerësimi i aktiveve jo në përdorim	2,174	4,580
Aktive të tjera të njohura si shpenzim	5,560	12,398
Tarifa disbursimi të shtyra	1,741	12,120
Shpenzime të pazbritshme	136,276	88,906
Fitmi i tatueshëm / (humbje)	(699,610)	(350,485)

26. Angazhime dhe garanci

Angazhimet dhe garancitë në 31 dhjetor 2009 përfshijnë garancitë e vendosura nga dhe të dhëna klientëve si më poshtë:

	31 dhjetor 2009	31 dhjetor 2008
Garancitë pasive		
Garancitë në favor të klientëve	248,650	232,708
Angazhime kredituese të patërhequra	234,005	564,753

Garancitë e vendosura nga klientët e kredisë përfshijnë bllokimet në para dhe aktive të tjera të vendosura peng në favor të Bankës.

Banka siguron garanci performance në favor të palëve të treta. Këto marrëveshje kanë limite fikse dhe zakonisht lëshohen për periudha deri në dy vjet.

(Të gjitha shifrat janë shprehur në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

26. Angazhime dhe garanci (vazhdim)

Çështjet gjyqësore

Gjatë aktivitetit normal Banka mund të ballafaqohet me çështjet ligjore. Në 31 dhjetor 2009 dhe 31 dhjetor 2008 Banka nuk ka asnjë çështje ligjore pezull.

Angazhime për qeratë

Banka ka hyrë në angazhime qeraje për ambientet e zyrave qendrore dhe pjesën më të madhe të degëve përmes qerave operationale nga 5 vjet deri në 10 vjet. Banka nuk zotëron opion për të blerë aktivet në fund të periudhës së qerasë.

Angazhime të tilla përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2009	31 dhjetor 2008
Më pak se një vit	10,271	191,984
Nga një vit deri në pesë vjet	686,187	727,069
Mbi pesë vjet	183,682	309,528
Totali	880,140	1,228,581

27. Transaksionet me palët e lidhura

Aksioneri kryesor i bankës më 31 dhjetor 2009 është Societe Generale.

Një numër i transaksioneve bankare janë realizuar me palët e lidhura gjatë rrjedhës normale të biznesit. Kjo përfshin kredi, depozita dhe transaksione të tjera. Këto transaksione u realizuan mbi terma tregtare dhe kushtet e tregut.

Banka ka transaksionet vijuese me aksionerët e saj gjatë vitit 2009 termat kontraktuale të së cilave janë detajuar si më poshtë:

	Shuma	Norma e interesit	Datë valuta	Data e maturimit
Hua	8,967	0.45%	31 dhjetor 2009	5 janar 2010
Llogari rrjedhëse	93,364	-	-	-

Banka ka transaksionet vijuese me aksionerët e saj gjatë vitit 2008 termat kontraktual të së cilave janë detajuar si më poshtë:

	Shuma	Norma e interesit	Datë valuta	Data e maturimit
Depozitë	185,763	2.02%	24 dhjetor 2008	7 janar 2009
Hua	619,748	3.30%	18 dhjetor 2008	18 qershor 2009
Llogari rrjedhëse	(22,272)	-	-	-

(Të gjitha shifrat janë shprehur në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

27. Transaksionet me palët e lidhura (vazhdim)

	Drejtore		Bordi Drejtues	
	2009	2008	2009	2008
<i>Kredi</i>				
Kredi gjendje në fillim të vitit	9,625	7,776	236,892	357,611
Kredi të dhëna gjatë vitit	600	5,232	33,082	-
Kredi të shlyera gjatë vitit	(4,605)	(3,383)	(14,677)	(120,719)
Kredi gjendje në fund të vitit	5,620	9,625	255,297	236,892
Interesa të fituara	767	604	52,764	26,229
<i>Llogari rrjedhëse dhe depozita</i>				
Depozita në fillim të vitit	196,965	187,373	42,755	34,735
Depozita të marra gjatë vitit	33,563	82,431	-	38,000
Depozita të shlyera gjatë vitit	(11,560)	(72,839)	(156,584)	(29,980)
Depozita gjendje në fund të vitit	218,968	196,965	(113,829)	42,755
Interesi i paguar	(7,381)	(4,940)	(13,764)	(1,395)
Të ardhura nga tarifat dhe komisionet	190	42	183	104
Fitimet nga transaksionet në monedhë të huaj	35	37	706	295
Kompensimi i drejtimit	(68,574)	(46,519)	(20,475)	(21,551)
Garanci të lëshuara	-	(10,894)	-	-

Shumat e paraqitura në lidhje me klasifikimet e Drejtorëve dhe Bordit të Drejtorëve përfshijnë anëtarë të afërt të familjeve të tyre si dhe biznese të kontrolluara, bashkarisht të kontrolluara ose të ndikuara në mënyrë të konsiderueshme nga, ose për rastet kur fuqia votuese e konsiderueshme bie në mënyrë direkte ose indirekte mbi çdo Drejtor ose të afërm të familjes së tij.

28. Ngjarjet pas periudhës raportuese

Nuk ka ndonjë ngjarje pas periudhës raportuese që mund të kërkojë rregullim ose shënime shtesë në pasqyrat financiare.

29. Adminstrimi i rrezikut financiar

(a) Të përgjithshme

Përdorimi i instrumentave financiarë e ekspozojnë Bankën ndaj rreziqeve të mëposhtme:

- rreziku i kreditimit
- rreziku i likuiditetit
- rreziku i tregut
- rreziku operacional

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Bankës ndaj çdo rreziku të përmendur më lart, objektivat, politikat dhe proceset për vlerësimin dhe administrimin e rrezikut, dhe administrimin e kapitalit të Bankës.

Struktura e administrimit të rrezikut

Bordi Drejtues ka përgjegjësi për ndërtimin dhe vëzhgimin e strukturës së administrimit të rrezikut. Bordi ka themeluar Komitetin e Aktiveve dhe Detyrimeve (ALCO) dhe Komitetin e Kredisë së Bankës, e atë Operacional, të cilët janë përgjegjës për zhvillimin dhe monitorimin e politikave të administrimit të rrezikut në fushat e tyre specifike. Komitetet përbëhen nga anëtarë ekzekutiv dhe jo-ekzekutiv dhe raportojnë rregullisht tek Bordi Drejtues.

Politikat e administrimit të rrezikut janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet e hasura nga Banka, për të vendosur kufizime dhe kontrole dhe për të monitoruar zbatimin e këtyre kontroleve. Politikat e administrimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet, produktet dhe shërbimet e tregut. Banka nëpërmjet trajnimeve dhe standardeve dhe procedurave drejtuese, synon të zhvillojë një mjedis kontrolli të disiplinuar dhe konstruktiv në të cilin çdo punonjës do kuptojë rolin dhe detyrimet përkatëse.

Komiteti i kontrollit është përgjegjës për monitorimin e përpunueshmërisë me politikat dhe procedurat e administrimit të rrezikut dhe për të vlerësuar mjaftueshmërinë e strukturës së administrimit të rrezikut në lidhje me rreziqet e hasura nga Banka. Komiteti i kontrollit mbështetet nga kontrolli i brendshëm i Bankës për të kryer funksionet e veta. Kontrolli i brendshëm vëzhgon në mënyrë të rregullt dhe 'ad-hoc' politikat dhe procedurat e administrimit të rrezikut dhe raporton rezultatet vëzhgimeve tek Komiteti i Kontrollit.

Zhvillimet aktuale

Banka operon në kushtet e një zhvillimi dinamik të një krize financiare dhe ekonomike. Zgjerimi i saj mund të rezultojë në implikime negative të pozicionit financiar të Bankës. Menaxhimi i Bankës përformon çdo ditë monitorimin e pozicioneve të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve, si edhe të zhvillimit të tregjeve ndërkombëtare financiare, duke vënë në zbatim praktikat më të mira Bankare. Menaxhimi është i bazuar në analizat e fitimit, likuiditetit dhe kostos së fondeve dhe merr masa të përshtatshme në lidhje me kreditimin, tregun (kryesisht normën e interesit) dhe rrezikun e likuiditetit duke kufizuar kështu efektet e mundshme negative të krizës globale financiare dhe ekonomike. Në këtë mënyrë Banka i përgjigjet ndryshimeve të tregut duke mbajtur një kapital dhe një pozicion likuiditeti të qëndrueshëm.

(b) Rreziku i kreditit

Rreziku i kreditimit është rreziku i humbjes financiare nëse klienti apo pala tjetër në një instrument financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet kontraktuale që rrjedhin nga ky instrument. Ky rrezik vjen kryesisht nga kreditë dhe paradhëniet për klientët, bankat e tjera dhe investimi në letra me vlerë.

29. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kreditit (vazhdim)

Për qëllime raportimi të administrimit të rrezikut të kredisë, Banka konsideron të gjitha elementët e ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë (si rreziku që rrjedh nga vet klienti, pozicioni gjeografik dhe sektori). Për qëllime të menaxhimit rreziku kreditues që rrjedh nga tregëtimi i letrave me vlerë menaxhohet në mënyrë të pavarur, por raportohet si pjesë e rrezikut të ekspozimit ndaj tregut.

Administrimi i rrezikut të kreditimit

Bordi i drejtuesve ka deleguar përgjegjësinë për administrimin e rrezikut tek Komiteti i Kreditimit të Bankës. Një sektor i vecantë i administrimit të rrezikut të kreditimit, që raporton tek Shefi i Rrezikut dhe paralelisht tek Drejtori Ekzekutiv është përgjegjës për mbikëqyrjen e rrezikut kreditues së Bankës. Administrimi i rrezikut arrihet me:

- Formulimin e politikave të kreditimit duke u konsultuar me njësitë e biznesit, duke mbuluar kërkesat për kolateral, vlerësimin e kredive, vlerësimin dhe raportimin e rrezikut dhe përputhshmërinë me ligjet dhe procedurat ligjore në fuqi.
- Themelimin e strukturës autorizuese për aprovimin dhe rinovimin e faciliteteve. Bordi Drejtues delegon autoritetin e tij për aprovimin e limiteve Komitetit të Kreditimit (aktualisht për shumat deri në 1 milion Euro ose ekuivalentet në Lek ose monedha të tjera).
- Mbikëqyrjen dhe vlerësimin e rrezikut të kreditimit. Banka vlerëson të gjitha ekspozimet ndaj rrezikut të kreditimit të cilat e kalojnë kufirin e vendosur, para aprovimit përfundimtar të disbursimit. Rinovimet dhe rishikimet e faciliteteve janë subjekt i të njëjtit proces.
- Kufizimi i përqëndrimit të ekspozimit të kundërpalëve. Banka strukturon nivelet e rrezikut të kreditimit që ndërmeret duke vendosur limite mbi shumën e riskut të pranuar në lidhje me një huamarrës ose një grup
- huamarrësish. Për më tepër limitet e përqëndrimit sipas sektorëve të ekonomisë po përcaktohen. Rreziqe të tilla monitorohen mbi baza të përtëritshme dhe janë subjekt i një rishikimi vjetor ose më të shpejtë sipas nevojës.
- Mbikëqyrja e ekspozimit aktual ndaj limiteve në mënyrë të shpeshtë. Ekspozimi ndaj rrezikut kreditues administrohet përmes një analize të rregullt të aftësisë së huamarrësit për përballuar riparimet e kapitalit dhe interesit, madje dhe duke i ndryshuar dhe keto limite kreditimi kur është e përshtatshme.
- Zhvillimin dhe përdorimin e sistemit të vlerësimit të rrezikut të Bankës në mënyrë që të kategorizojë ekspozimin në bazë të shkallës së rrezikut të humbjeve financiare dhe të fokusojë Drejtimin në rreziqet aktuale të Bankës. Sistemi i kategorizimit të rrezikut përdoret për të përcaktuar se kur duhet të krijohen fonde për zhvlerësime të mundshme kundrejt ekspozimeve specifike ndaj rrezikut të kreditimit. Sistemi aktual i kategorizimit të rrezikut bazohet në një kategorizim të portofolit të huave në hua që janë ose jo me problem, të klasifikuara në 8 kategori dhe nën kategori, të cilat reflektojnë nivele të ndryshme rrezikun e mospagimit dhe vlefshmërinë e kolateralit ose zvogëlimin e rreziqeve të tjera të kreditit. Përgjegjësia për vendosjen e niveleve të rrezikut është e Drejtimit të rrezikut të kreditit dhe është subjekt i aprovimit final nga Komiteti i Kredisë ose Drejtimi. Vendosja e shkallës të rrezikut është gjithashtu subjekt i Societe General dhe i politikave dhe direktivave të Grupit.

29. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kreditimit (vazhdim)

Ekspozimi ndaj rrezikut kreditues

(i) *Hua dhënë bankave dhe letrat me vlerë të vlefshme për shitje*

Që nuk është me vonesë as humbje	31 dhjetor 2009	31 dhjetor 2008
<i>Hua dhënë institucioneve financiare</i>		
Rrezik i ulët (banka tregtare)	240,474	286,345
<i>Letra me vlerë të vlefshme për shitje</i>		
Obligacione qeveritare dhe Bono Thesari	14,832,681	16,712,884
Totali i vlerës së mbetur	15,073,155	16,999,229

(ii) *Hua dhe paradhënie klientëve, neto*

	31 dhjetor 2009	31 dhjetor 2008
<i>Të zhvlerësuar individualisht</i>		
Shkalla 7: Nënstandarde	278,312	84,439
Shkalla 8a: Të dyshimta	237,950	27,167
Shkalla 8b: Të humbura	499,716	65,013
Vlera bruto	1,015,978	176,619
Fondi për zhvlerësim	(390,529)	(107,881)
Vlera kontabël (A)	625,449	68,738
<i>Fonde për humbjet bazuar në portofol</i>		
Shkalla 1-3: Standarte (Rrezik i ulët)	12,275,944	10,575,549
Shkalla 4: Në vëzhgim	1,781,784	716,803
Shkalla 7: Nënstandarde	569,047	460,736
Shkalla 8a: Të dyshimta	266,999	707,369
Shkalla 8b: Të humbura	846,444	565,584
Vlera bruto	15,740,218	13,026,041

(Të gjitha shifrat janë shprehur në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

Fondi për zhvlerësim	(360,372)	(177,760)
Vlera kontabël (B)	15,379,846	12,848,281
Hua dhënë Qeverisë Shqiptare Shkalla (Standarde) (C)	1,454,864	-
Totali (A+B+C)	17,460,158	12,917,019
<i>Me vonesë por jo të zhvlerësuara përfshin:</i>		
30-90 ditë: Në vëzhgim	1,781,784	716,803
90-180 ditë: Nënstandarte	569,047	460,736
180 ditë - 270 ditë: Të dyshimta	266,999	707,369
270 + ditë: Të humbura	846,444	565,584
Vlera kontabël	3,464,274	2,450,492

29. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)**(b) Rreziku i kreditimit (vazhdim)****(ii) Hua dhe paradhënie klientëve, neto (vazhdim)*****Hua dhe letra me vlerë të zhvlerësuara***

Hua dhe letra me vlerë të zhvlerësuara janë ato hua dhe letra me vlerë për të cilat Banka ka përcaktuar se është e mundur që ajo mos të arkëtojë të gjithë shumën e interesit dhe të huasë në bazë të kushteve të kontratës.

Hua me vonesë por jo të zhvlerësuara

Hua dhe letra me vlerë ku pagesat e interesit dhe principalit janë me vonesë por që Banka beson se zhvlerësimi nuk është i përshtatshëm për shkak të sigurisë / kolateralit të vlefshëm dhe /ose shkallës së arkëtimit të shumës së huasë.

Hua me kushte të rinegociueshme

Hua me kushte të rinegociueshme janë hua të cilat janë ristrukturuar për shkak të përkeqësimit të situatës financiare të klientit dhe kur Banka ka bërë lëshime të cilat nuk do ti bënte në rast të kundërt. Pasi huaja është ristrukturuar qëndron në të njëjtën kategori edhe pse performanca pas ristrukturimit mund të përmirësohet.

Fondi për zhvlerësim

Banka vendos një provigjon për humbjet nga zhvlerësimet që përfaqëson vlerësimin e Bankës për humbjet e ndodhura të portofolit. Përbërësit kryesorë të këtij provigjoni janë, një komponent për humbjet specifike që lidhet me ekspozimet e konsiderueshme dhe një provigjon të përgjithshëm për grupet e aktiveve të ngjashme në lidhje me humbjet e realizuara por që nuk janë identifikuar në huatë që janë subjekt i vlerësimit individual për zhvlerësime.

Politika e nxjerrjes jashtë bilancit

Banka nxjerr jashtë pozicionit financiar një hua/letër me vlerë (dhe çdo provigjon për humbjet nga zhvlerësimi) kur Komiteti i Kredive me probleme të Bankës vendos që huatë/ letrat me vlerë janë të pa arkëtueshme. Ky përcaktim arrihet pasi janë marrë në konsideratë informacione si ndodhja e ngjarjeve të konsiderueshme të cilat kanë ndikuar në gjëndjen financiare të huamarrësit në mënyrë të tillë që ai nuk është në gjëndje të paguajë detyrimin, ose të ardhurat nga ekzekutimi i kolateralit nuk do të jenë të mjaftueshme për të mbuluar ekspozimin total. Për shumën të vogla të huave standarte vendimet për zhvlerësimin bazohen në gjëndjen e vonesës së produktit specifik si dhe në veprimet ligjore që ndiqen për proçedura përforcuese.

(Të gjitha shifrat janë shprehur në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

29. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kreditimit (vazhdim)

(ii) Hua dhe paradhënie klientëve (vazhdim)

Më poshtë është paraqitur analiza e shumave neto dhe bruto (e provigjoneve për zhvlerësim) të aktiveve individualisht të zhvlerësuara sipas shkallës së riskut.

	31 dhjetor 2009	
	Bruto	Neto
<i>Individualisht të zhvlerësuara</i>		
Shkalla 7 : Nënstandarde	278,312	195,683
Shkalla 8a: Të dyshimta	237,950	144,950
Shkalla 8b: Të humbura	499,716	284,816
Totali	1,015,978	625,449

	31 dhjetor 2008	
	Bruto	Bruto
<i>Individualisht të zhvlerësuara</i>		
Shkalla 7 : Nënstandarde	84,439	35,148
Shkalla 8a: Të dyshimta	27,167	10,163
Shkalla 8b: Të humbura	65,013	23,427
Totali	176,619	68,738

Banka mban kolaterale për huatë dhe paradhëniet për klientët. Banka aplikon procedura të brendshme mbi pranueshmërinë e klasave specifike të kolateralit si dhe zbutjen e rrezikut të kreditimit.

Banka mban kolaterale ne format e mëposhtme:

- Hipotekë mbi pasuri të paluajtshme;
- Barrë siguruese mbi aktivet operuese të biznesit si paisje, makineri, inventar dhe llogari të arkëtueshme;
- Para të bllokuara dhe letra me vlerë (p.sh Bono thesari) etj.

Vlerësimet e vlerës së drejtë bazohen në vlerën e kolateralit të vlerësuar në momentin e disbursimit dhe në përgjithësi nuk rifreskohen në baza vjetore. Rishikimi ndodh kur kredia është në vonesë, përveç rasteve kur rishikimi kërkohet nga klienti ose ka një rënie në çmimin e tregut të ndërtesës. Për huatë që u jepen Bankave të tjera nuk mbahet kolateral, përveç rasteve kur letrat me vlerë mbahen si pjesë e riblerjeve të anasjellta dhe aktivitetit huamarrës të letrave me vlerë.

29. Administrimi i riskut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kreditimit (vazhdim)

(ii) Hua dhe paradhënie klientëve (vazhdim)

Përqendrimi i rrezikut të kreditimit sipas sektorëve të ekonomisë në 31 dhjetor 2009 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2009		31 dhjetor 2008	
Tregti	4,232,583	25%	3,486,179	26%
Ndërtim	3,661,200	22%	3,391,894	26%
Shërbime	3,616,918	22%	1,684,360	13%
Industria e prodhimit dhe përpunimit	1,449,194	9%	1,829,139	14%
Telekomunikacion	297,418	2%	470,050	4%
Agrikulturë dhe peshkim	127,953	1%	353,122	2%
Institucione publike	105,219	1%	409,526	3%
Të tjera	3,265,710	19%	1,578,391	12%
Totali	16,756,195	100%	13,202,661	100%

Rreziku i vendosjes

Aktivitetet e Bankës mund të shkaktojnë rrezik në momentin e realizimit të transaksioneve. Rreziku i vendosjes është rreziku i humbjeve për shkak të dështimit të një shoqërie në përmbushjen e detyrimeve të saj në para, letra me vlerë ose aktive të tjera ashtu siç është rënë dakord në kontratë.

Për disa transaksione të veçanta Banka mund të zvogëlojë këtë rrezik duke vendosur transaksione nëpërmjet një agjenti për tu siguruar që transaksioni stabilizohet atëherë kur të dyja palët kanë plotësuar detyrimet e tyre. Limitet në realizimin e transaksionit janë pjesë e procesit të monitorimit e të aprovimit/kufizimit të kredisë të përshkruar më sipër. Pranimi i rrezikut të vendosjes kërkon aprovime specifike prej palëve nga Administrimi i Rrezikut të Bankës..

(c) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Banka nuk do të jetë në gjendje të shlyejë detyrimet e saj financiare në kohën e duhur.

Administrimi i rrezikut të likuiditetit

Trajtimi i Bankës për administrimin e rrezikut të likuiditetit është për të siguruar që do të ketë gjithmonë fonde të mjaftueshme për të shlyer detyrimet e saj kur nevojitet, në kushte normale dhe tensionuara, pa pasur humbje të papranueshme ose duke rrezikuar reputacionin e Bankës. Politikat dhe procedurat e likuiditetit janë subjekt i aprovimit dhe rishikimit nga Bordi i Drejtorëve. Disa vendime mund t'i delegohen ALCO-s.

Procesi i administrimit të likuiditetit përfshin:

- Financimi ditë pas dite, administruar nga vezhgimi i rrjedhjeve të ardhshme të parasë që sigurojnë kërkesat mund të plotësohen. Kjo përfshin rivendosjen e fondeve kur ato maturohen ose merren hua nga klientët.
- Vëzhgimi i raporteve të likuiditetit të pozicionit financiar dhe krahasimi me procedurat dhe kërkesat e brendshme.
- Administrimi i përqëndrimit dhe profilit të maturimit të huave.

29. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)**(c) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)*****Administrimi i rrezikut të likuiditetit (vazhdim)***

Përgjegjësia për administrimin e pozicionit të likuiditetit ditor i mbetet departamentit të thesarit. Raporte ditore mbulojnë rrjedhjet e parave të projektuara për ditën e nesërme, javën dhe muajin, të cilët janë konsideruar si periudha kyce të administrimit të likuiditetit. Pika e fillimit për ato projekte është analiza e maturitetit kontraktual e detyrimeve financiare dhe data e pritshme e mbledhjes së aktivitetit financiar.

Drejtimi i likuiditetit afatshkurtër dhe afatmesëm është përgjegjësi e ALCO. ALCO analizon në bazë mujore pozicionin e likuiditetit të bankës dhe aprovon çdo veprim të gjykuar të nevojshëm.

Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit

Elementi kyç i përdorur për administrimin e rrezikut të likuiditetit është raporti i aktiveve likuide me pasivet afatshkurtra dhe hendeku 3 mujor kumulativ ndaj totalit të aktiveve. Për këtë arsye aktivet likuide konsiderohen paraja dhe ekuivalentët e saj dhe portofoli i letrave me vlerë të vlefshme për shitje. Raportet e likuiditetit të përcaktuara nga banka janë në përputhje me kërkesat e bankës së Shqipërisë të vendosura nga rregullorja “ Mbi administrimin e rrezikut të likuiditetit”.

Financimet janë krijuar duke përdorur një seri instrumentesh si p.sh depozita, detyrime të tjera të evidentuara në letër dhe aksione. Kjo përforcon fleksibilitetin e financimit, kufizon pavarësinë mbi çdo burim fondesh si dhe në përgjithësi ul kostot e financimit. Banka bën përpjekjet e saj për mbajtje të një balancë mes vazhdimësisë së fondeve dhe fleksibilitetit përmes përdorimit të detyrimeve me maturitet të ndryshëm. Banka vazhdimisht vlerëson rrezikun e likuiditetit duke identifikuar dhe monitoruar ndryshimet në financimin e kërkuar për të arritur objektivat e biznesit të përcaktuar në strategjinë e përgjithshme të bankës.

Tabela e mëposhtme tregon rrjedhjet e parasë së skontuar nga detyrimet dhe aktivet e bankës sipas periudha të ripagimit më të hershem të mundshëm.

Rrjedhjet e pritshme të Bankës mund të variojnë në mënyrë të konsiderueshme nga kjo analizë. Për shembull depozitat me afat të klientëve pritet të mbajnë një njëritje të qëndrueshme.

Për më tepër banka mban një portofol të aktiveve likuide si pjesë e strategjisë së administrimit të likuiditetit.

(Të gjitha shifrat janë shprehur në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

29. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(c) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Ekspozimi i Bankës ndaj rrezikut të likuiditetit në 31 dhjetor 2009 paraqitet si më poshtë:

Aktive	Deri në një muaj	Një deri në tre muaj	Tre deri në gjashtë muaj	Gjashtë deri në një vit	Një vit deri në pesë vjet	Mbi pesë vjet	Totali
Paraja dhe ekuivalentët e saj	1,792,012	-	-	-	-	-	1,792,012
Shuma të kushtëzuara	434,423	640,313	503,384	1,242,344	155,180	-	2,975,644
Hua dhënë institucioneve financiare	38,722	46,745	-	-	155,007	-	240,474
Investime të vlefshme për shitje	592,975	1,266,304	1,259,852	6,096,102	5,617,448	-	14,832,681
Hua dhënë klientëve, neto dhe Qeverisë Shqiptare	2,017,634	1,269,946	969,949	3,239,628	7,266,642	2,696,360	17,460,159
Aktive fikse të mbajtura për shitje	-	-	-	78,742	-	-	78,742
Aktive të tjera	-	-	-	116,024	-	-	116,024
Detyrime	4,875,766	3,223,308	2,733,185	10,772,840	13,194,277	2,696,360	37,495,736
Detyrime ndaj institucioneve financiare	1,854,457	98,172	-	434,656	132,962	-	2,520,247
Detyrime ndaj klientëve	8,436,238	5,875,457	4,619,012	11,399,645	1,423,923	-	31,754,275
Detyrime të tjera	239,896	-	-	8,538	-	-	248,434
Rreziku i likuiditetit	(5,654,825)	(2,750,321)	(1,885,827)	(1,069,999)	11,637,392	2,696,360	37,495,736
Kumulative	(5,654,825)	(8,405,146)	(10,290,973)	(11,360,972)	276,420	2,972,780	

29. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(c) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Ekspozimi i Bankës ndaj rrezikut të likuiditetit në 31 dhjetor 2008 paraqitet si më poshtë:

	Deri në një muaj	Një deri në tre muaj	Tre deri në gjashtë muaj	Gjashtë deri në një vit	Një vit deri në pesë vjet	Mbi pesë vjet	Totali
Aktive							
Paraja dhe ekuivalentët e saj	2,790,660	-	-	-	-	-	2,790,660
Hua dhënë institucioneve financiare	35,366	3,714	-	-	247,265	-	286,345
Investime të vlefshme për shitje	2,250,570	1,702,721	2,004,975	6,257,519	4,497,099	-	16,712,884
Hua dhe paradhënie klientëve , neto	1,615,358	593,777	1,043,516	1,657,128	5,769,027	2,238,213	12,917,019
Aktive të tjera dhe parapagim tatim fitimit	115,192	-	-	-	-	-	115,192
	6,807,146	2,300,212	3,048,491	7,914,647	10,513,391	2,238,213	32,822,100
Detyrime							
Detyrime ndaj institucioneve financiare	2,039,572	21,594	633,679	164,023	130,000	-	2,988,868
Detyrime ndaj klientëve	8,900,841	5,800,336	3,999,701	9,970,357	1,225,048	-	29,896,283
Detyrime të tjera	384,672	-	-	-	-	-	384,672
	11,325,085	5,821,930	4,633,380	10,134,380	1,355,048	-	33,269,823
Rreziku i likuiditetit	(4,517,939)	(3,521,718)	(1,584,889)	(2,219,733)	9,158,343	2,238,213	
Kumulative	(4,517,939)	(8,039,657)	(9,624,546)	(11,844,279)	(2,685,936)	(447,723)	

29. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimi në çmimet e tregut, si normat e interesit, çmimet e kapitalit, normat e kursit të këmbimit dhe normat e kredive (që nuk lidhen me ndryshimet në balancën e kredisë të kredihënësit apo kredimarrësit) do të ndikojë në të ardhurat e Bankës apo vlerën e instrumentave financiarë. Objektivi i administrimit të rrezikut të tregut është të manaxhojë dhe kontrollojë që ekspozimi ndaj rrezikut të tregut të jetë brenda parametrave të pranueshëm ndërkohë që optimizon kthimin nga rreziku.

Administrimi i rrezikut të tregut

Banka e ndan ekspozimin ndaj rrezikut të tregut në portofole të tregëtueshme dhe jo të tregëtueshme. Portofolet e tregëtueshme përfshijnë pozicione që lindin nga transaksionet në treg për rastet kur Banka tregëton për klientët ose për vete bashkë me aktivet dhe detyrimet financiare që drejtohen mbi bazën e vlerës së drejtë. Pozicioni valutor është trajtuar si pjesë e portofolit tregtar të Bankës për qëllime të administrimit të rrezikut.

Portofolet jo tregtare rrjedhin nga administrimi i rrezikut të normës së interesit të aktiveve dhe detyrimeve tregtare e bankare. Portofolet jo tregtare gjithashtu përbëhen nga rreziqe që rrjedhin nga investimet në letra me vlerë të mbajtura deri në maturim dhe të disponueshme për shitje të bankës.

Autoriteti për rrezikun e tregut i vishet ALCO. ALCO është përgjegjës për zhvillimin e detajuar të politikës së administrimit të rrezikut si dhe për kontrollin e zbatimit të saj ditë pas dite.

Ekspozimi ndaj rrezikut të tregut-portofole të tregtueshme

Banka është e ekspozuar ndaj efektit të luhatjeve në kurset e këmbimit të monedhave të huaja në pozicionin e saj financiar dhe rrjedhjes së parasë.

Ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit

Banka është e ekspozuar ndaj rrezikut të monedhës përmes transaksioneve në monedhë të huaj. Meqë monedha e përdorur nga banka në paraqitjen e pasqyrave financiare është Lek, pasqyrat financiare të bankës ndikohen nga luhatjet në kurset e këmbimit mes Lek-ut dhe monedhave të tjera.

29 Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziku i tregut (vazhdim)

Analiza e aktiveve dhe detyrimeve sipas monedhave më 31 dhjetor 2009 paraqitet si më poshtë:

	Lek	EUR	USD	Të tjera	Totali
Aktivitet					
Paraja dhe ekuivalentët e saj	454,121	327,051	822,218	188,622	1,792,012
Shuma të kushtëzuara me Bankën Qëndrore	2,029,175	797,979	148,490	-	2,975,644
Hua dhënë bankave dhe institucioneve financiare	201,752	38,638	84	-	240,474
Investime të vlefshme për shitje	14,832,681	-	-	-	14,832,681
Hua dhe paradhënie klientëve, neto	7,129,565	8,330,201	545,473	55	16,005,294
Hua dhënë Qeverisë Shqiptare	-	1,454,864	-	-	1,454,864
Aktive të tjera fikse	77,487	36,795	1,692	50	116,024
Totali	24,724,781	10,985,528	1,517,957	188,727	37,416,993
Detyrime					
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	1,995,435	518,887	5,922	4	2,520,248
Detyrime ndaj klientëve	21,403,014	8,712,637	1,452,826	185,798	31,754,275
Detyrime të tjera	185,028	60,481	-	2,925	248,434
Totali	23,583,477	9,292,005	1,458,748	188,727	34,522,957
Pozicioni neto	1,141,304	1,693,523	59,209	-	2,894,036

29 Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziku i tregut (vazhdim)

Analiza e aktiveve dhe detyrimeve sipas monedhave më 31 dhjetor 2008 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2008				
	Lek	EUR	USD	Të tjera	Totali
Aktivet					
Paraja dhe ekuivalentët e saj	648,626	1,228,354	706,678	207,002	2,790,660
Shuma të kushtëzuara	2,022,708	707,944	145,965	-	2,876,617
Hua dhënë bankave dhe institucioneve financiare	247,265	39,003	77	-	286,345
Investime të vlefshme për shitje	16,712,884	-	-	-	16,712,884
Hua dhe paradhënie klientëve	5,990,174	6,329,420	591,551	5,874	12,917,019
Aktive të tjera dhe parapagim i tatim fitimit	96,991	17,842	355	4	115,192
Totali	25,718,648	8,322,563	1,444,626	212,880	35,698,717
Detyrime					
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	2,218,047	764,979	5,814	28	2,988,868
Detyrime ndaj klientëve	21,218,318	7,065,831	1,400,186	211,948	29,896,283
Detyrime të tjera	168,245	212,917	2,608	905	384,672
Totali	23,604,610	8,043,727	1,408,608	212,881	33,269,826
Pozicioni neto	2,114,038	278,836	36,018	(1)	2,428,891

29 Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziku i tregut (vazhdim)

Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit – portofoli jo i tregtueshëm

Rreziku primar ndaj të cilit janë ekspozuar portofolet jo të tregtueshme është rreziku i humbjeve nga luhatjet e rrjedhjes së ardhshme të parasë ose vlerës së drejtë të instrumentave financiar për shkak të ndryshimit në normat e interesit të tregut.

ALCO përkufizon dhe rishikon politikën e çmimit të normës së interesit për aktivet dhe detyrimet financiare. Administrimi i rrezikut të normës së interesit ndaj hendekut të limiteve të normave të interesit është plotësuar përmes monitorimit të luhatshmërisë së aktiveve dhe detyrimeve financiare të Bankës sipas skenarëve standart dhe të ndryshëm të normës së interesit. Skenarët standart që janë konsideruar cdo muaj përfshijnë 100 pikë bazë rënie ose ngritje paralele në të gjithë kurbat e interesit. Një analizë e luhatshmërisë së Bankës ndaj rritjes ose zvogëlimit të normës së interesit me 100 pikë (duke supozuar asnjë lëvizje asimetrike në kurbat e normave dhe pozicion bilanci konstant) është si më poshtë:

2009					
	Skenar			Skenar	
	Deri në një vit			Mbi një vit	
	100 pikë	100 pikë	100 pikë	100 pikë	100 pikë
	rritje	zvogëlim	rritje	zvogëlim	zvogëlim
Efekti i vlerësuar fitim/(humbje)	(14,196)	14,196	29,424	(29,424)	(29,424)
2008					
	Skenar			Skenar	
	Deri në një vit			Mbi një vit	
	100 pikë	100 pikë	100 pikë	100 pikë	100 pikë
	rritje	zvogëlim	rritje	zvogëlim	zvogëlim
Efekti i vlerësuar fitim/(humbje)	(16,857)	16,857	33,871	(33,871)	(33,871)

(Të gjitha shifrat janë shprehur në mijë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

29 Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziku i tregut (vazhdim)

Normat efektive mesatare të kthimit për kategori të rëndësishme të aktiveve dhe detyrimeve financiare të Bankes me 31 dhjetor 2009 dhe 2008 ishin si më poshtë:

	Normat mesatare të interetit të ponderuara (Lek)		Normat mesatare të interesit të ponderuara (USD)		Normat mesatare të interesit të ponderuara (EUR)	
	2009	2008	2009	2008	2009	2008
31 Dhjetor						
Aktive						
Paraja dhe ekuivalentët e saj	-	6.40%	0.45%	0.15%	-	2.28%
Shuma të kushtëzuara me Bankën Qëndrore	4.03%	4.17%	0.69%	1.70%	0.85%	3.27%
Hua dhënë bankave	8.47%	9.42%	0.33%	-	1%	-
Investime të vlefshme për shitje	8.68%	8.35%	-	-	-	-
Hua dhe paradhënie klientëve, neto	12.24%	13.49%	7.88%	8.50%	7.25%	8.65%
Detyrime						
Detyrime ndaj institucioneve financiare	5.97%	6.24%	0.1%	0.59%	5.39%	4.03%
Detyrime ndaj klientëve	6.63%	6.94%	1.65%	2.18%	4.33%	4.85%

29 Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziku i tregut (vazhdim)

Një analizë e bankës për sa i përket normës së interesit të ri-çmuar në 31 dhjetor 2009 është si më poshtë:

Aktive	Deri në një muaj	Një deri në tre muaj	Tre deri në gjashtë muaj	Gjashtë deri në një vit	Mbi një vit	Pa interes	Totali
Paraja dhe ekuivalentët e saj	1,057,218	-	-	-	-	734,794	1,792,012
Shuma të kushtëzuara me Bankën Qëndrore	-	2,974,105	-	-	-	1,539	2,975,644
Hua dhënë bankave dhe institucioneve të kreditit	38,722	-	-	-	201,752	-	240,474
Investime të vlefshme për shitje	1,022,908	1,465,970	1,344,992	6,701,242	4,297,569	-	14,832,681
Hua dhënë klientëve, neto dhe Qeverisë Shqiptare	799,022	2,722,546	3,059,819	10,111,504	-	767,268	17,460,159
	2,917,870	7,162,621	4,404,811	16,812,746	4,499,321	1,503,601	37,300,970
Detyrime							
Detyrime ndaj institucioneve financiare	1,854,458	98,172	-	434,656	132,962	-	2,520,248
Detyrime ndaj klientëve	8,436,238	5,875,457	4,619,012	11,399,645	1,423,923	-	31,754,275
	10,290,696	5,973,629	4,619,012	11,834,301	1,556,885	-	34,274,523

29 Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziku i tregut (vazhdim)

Një analizë e bankës për sa i përket normës së interesit të ri-çmuar në 31 dhjetor 2008 është si më poshtë:

Aktive	Deri në një muaj	Një deri në tre muaj	Tre			Mbi një vit	Pa interes	Totali
			deri në gjashtë muaj	Gjashtë deri në një vit	Gjashtë deri në një vit			
Paraja dhe ekuivalentët e saj	1,797,951	-	-	-	-	992,709		2,790,660
Shuma të kushtëzuara me Bankën Qëndrore	-	2,874,592	-	-	-	2,025		2,876,617
Hua dhënë bankave dhe institucioneve të kreditit	35,366	3,714	-	-	245,000	2,265		286,345
Investime të vlefshme për shitje	2,250,569	1,702,721	2,004,975	6,257,519	4,497,100	-		16,712,884
Hua dhe paradhënie klientëve, neto	4,319,609	1,558,882	2,656,139	4,382,389	-	-		12,917,019
Detyrime	8,403,495	6,139,909	4,661,114	10,639,908	4,742,100	996,999		35,583,525
Detyrime ndaj institucioneve financiare	2,039,571	21,594	633,679	164,024	130,000	-		2,988,868
Detyrime ndaj klientëve	8,900,842	5,800,336	3,999,701	9,970,356	1,225,048	-		29,896,283
	10,940,413	5,821,930	4,633,380	10,134,380	1,355,048	-		32,885,151

29 Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(e) Rreziku operacional

Rreziku operacional është rreziku i humbjes së drejtpërdrejtë apo të tërthortë që vjen si rezultat i një sërë shkaqesh të lidhura me proceset, personelin, teknologjinë dhe infrastrukturën e Bankës dhe nga faktorë të jashtëm siç janë kreditimi i tregut dhe rreziqet e likuiditetit që lindin nga kërkesat ligjore dhe rregulluese si edhe nga standardet përgjithësisht të pranuar të sjelljes korporative. Rreziqet operative lindin si pasojë e të gjithë operacioneve të Bankës dhe shqyrtohen nga të gjitha njësitë e biznesit.

Objekti i Bankës është të menaxhoje rrezikun operacional në mënyre që të balancojë shmangien e humbjeve financiare dhe dëmtimin e reputacionit të Bankës me kosto efektive, si edhe të shmangë procedurat e kontrollit të cilat kufizojnë iniciativën dhe kreativitetin

Përgjegjësia parësore për zhvillimin dhe implementimin e kontrolleve për të adresuar rrezikun operativ i caktohet Drejtimit të Lartë për çdo njësi biznesi. Kjo përgjegjësi mbështetet nga zhvillimi i standardeve të përgjithshme të Bankës për menaxhimin e rrezikut operativ në fushat e mëposhtme:

- kërkesa për ndarjen e duhur të detyrave, duke përfshirë dhe autorizimin e pavarur të transaksioneve
- kërkesa për bashkërendimin dhe monitorimin e transaksioneve
- përputhja me kërkesat ligjore dhe rregullative
- dokumentim i kontrolleve dhe i procedurave
- kërkesa për vlerësimin periodik të risqeve operative të analizuar dhe përshtatshmërinë e kontrolleve dhe procedurave për të adresuar risqet e identifikuar
- kërkesa për raportimin e humbjeve operative dhe veprimit rregullues të propozuar
- zhvillimi i planeve të emergjencës
- trajnim dhe zhvillim profesional
- standardet etike dhe të biznesit
- zvogëlim i rrezikut duke përfshirë sigurim në rastet kur është efektiv.

Përputhshmëria me standardet e bankës mbështetet nga një program rishikimesh periodike i ndërmarrë nga një strukturë specifike e rrezikut operacional, duke përfshirë dhe kontrollin e brendshëm.